

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE  
E RAPORTIT PARAPRAK TE  
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË  
MJEDIS  
NDËRTIMI HEC-it QAM  
BASHKIA KUKËS

SHOQERIA "ECO ENERGY" SH.P.K.

STUDIO "ZENIT&CO"SH.PK

Ekspert Mjedisi Yzeir MIRAKA

Ing Mjedisi Kristaq GJOKA

## HYRJE

Rajoni ne te cilindo te ndertohet "HEC QAM" gjendet ne zonen malore veri lindore te Shqiperise ne luginen e perroit te Serrishtes, njesia Administrative Malzi, qarku Kukes, Midis Fshatit Came dhe Megulle. Ndertimi i hidrocentraleve dhe impjanteve te tjera per prodhimin e energjise elektrike nga burimet e rinovueshme, ka marre perparesi te madhe keto vitet e fundit. Ne kohen e sotme ndertimi i hidrocentraleve stimulohet dhe nga komuniteti Evropian, i cili ka aprovuar nje plan veprimi per politiken energjetike, qe parashikon, pervec te tjerash, dhe objektivin per te arritur brenda vitit 2020, 20 % te prodhimit nga burimet e energjise se rinovueshme, kundrejt konsumit total energjetik te Bashkimit Europian. Ne kete objektivi per prodhimin e energjise elektrike nga burimet e rinovueshme, nje potencial te rendesishem paraqet energjia e ujit. Tendenca e kerkeses per energji dhe vecanerisht per energjine elektrike vjen duke u rritur. Kriza energjetike e dekadave te fundit e ka veshituesuar se tepermi plotesimin e kerkeses per energji elektrike, gje qe ka bere qe prodhimi i saj nga burimet e rinovueshme te marre nje shtyese te rendesishme. Ne kohen e sotme, burimet tradicionale per prodhimin e energjise elektrike si nafta, gazi, qymyri, etj, po behen gjithmone me deficitare, me te kerkuara dhe me te kushtueshme. Nga ana tjetere, ngrohja globale dhe ndotja e ambientit nga clirimi i gazrave dhe mbetjeve te tjera, po behen gjithmon e me shqetesuese per komunitetin nderkombetar. Te gjithet keta faktore kane bere qe mjaft vende, per te perballuar kerkesen per energji elektrike, po tentojne gjithnje e me shume prodhimin e saj nga burime te rinovueshme. Shqiperia eshte nje vend ku uji perben nje potencial natyror energjetik mjaft te rendesishem. Kushtet klimaterike dhe terreni malor i thyer me perenj te shumte favorizojne ndertimin e hidrocentraleve te vegjel e te mesem, per prodhimin e energjise elektrike. Projekti i paraqitur parashikon nje kapacitet te pergjithshem **N ist = 780 kwh**. Prodhimi mesatar vjetor i energjise elektrike parashikohet te jete rreth **E totale = 3,006,279 Kwh/vit**. Pervec prodhimit te energjise elektrike, projekti do te kete dhe nje impakt pozitiv per komunitetin ne zonen ku do te ndertohet, si ne drejtim te permiresimit te infrastruktures rrugore, ashtu dhe ne drejtim te punesimit, perfitimit nga taksat, etj Në vitin 2013 Qeveria Shqiptare aprovoi Strategjinë Kombëtare të Energjisë (2013-2020), si një dokument bazë të zhvillimit të të gjithë sektorëve energjistikë deri në vitin 2015. Strategjia analizon tre çështje:

- 1) Situatën e furnizimit dhe kërkesës së energjisë deri në vitin 2020.
- 2) Strukturën institucionale të sektorit të energjisë.
- 3) Përgatitjen e paketës financiare dhe të afateve kohore për implementimin e secilës masë, në bazë të rekomandimeve të rezultuara nga Strategjia Kombëtare e Energjisë.

*Objektivi Primar i Strategjisë Kombëtare të Energjisë është:*

"Rikonstruimi i sektorit energjistik bazuar në parimet e ekonomise së tregut dhe në zhvillimin e një politike bashkëkohore energjitike" Nje nder sfidat kryesore eshte dhe liberalizimi i te gjithet tregut te energjise, dalja ne treg e konsumatoreve te energjise ku ata kane te drejte te zgjedhin operatorin e elektrike, pra ne nje treg te hapur qe rregullohet ne kerkesa dhe oferta. Liberalizimi I energjise do ti jape nje fryme te re zhvillimit te ekonomise dhe performances se sherbimit te energjise elektrike, ku ne nje vend importueste energjise ne do te behemi ne nje vend eksportues I energjise elektrike. Duke qene nje energji e rinovueshme, ne jemi ne linje me Direktivat e EU, ku deri ne vitin 2050 cdo shtet anetar I Eu duhet te gjeneroje 80 % te enegjise nga burime te energjise se rinovueshme. Nga progres raporti i vitit 2015, publikuar n netort te vitit 2016 theksojeh se Shqiperi ka bere progress ne sektorin e energjise, ku 38 % e energjise vjen nga burimet e nergjise se rinovueshme, ka potencial te larte ne kete fushe por gjithmone duke perdorur me eficence. Strategjia Kombëtare e Energjisë parashtron Kërkesat e domosdoshme për të plotësuar detyrimet e vendit tonë përkundrejt Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike në vendet e Europës JugLindore. Për këtë vendi yne duhet të plotësoje të gjitha obligimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe të harmonizojë zhvillimin e sektorit energjistik ne përputhje me Direktivat e Bashkepunimit Europian, për të bërë të

mundur asocimin e Shqipërisë në Europën e Bashkuar. Shqipëria është palë e një numri Konventash Ndërkombëtare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj), dhe tashmë ka një paketë të plotë ligjore për masat mbrojtëse të mjedisit dhe vlerësimin e impaktit mjedisor të veprimtarive, shërbimeve apo ndërtimeve në mjedisin ku veprojnë. Ky kuadër ligjor dhe angazhimet ndërkombëtare në fushën e mjedisit, shtrojnë shumë detyra ndaj institucioneve për të zbatuar një sistem sa më efektiv për administrimin e ujërave, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit për prodhimin e energjisë elektrike, tashmë shumë problematik në Shqipëri dhe në rajon, por edhe të zbatimit të përgjegjësive të rrjedhura nga këto marrëveshje ndërkombëtare. Ky raport paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kërkesë të Subjekti “EKO ERGY” Me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave ” nr. 550 date 15/07/2020, kërkon që të nxierr leje të shfrytëzimit, të ujit në perroi të Qamit për prodhimin e energjisë elektrike . Objekti i vlerësimit të këtij raporti është projekti për ndërtimin e HEC-it. Raporti parashikon ndikimet në mjedis nga punimet e ndërtimit të kaptazhit, basenit të dekantimit, kanali I derivacionit , baseni I presionit, tubacioni I presionit, sallen e godines së hecit, shkarkimin në rrjedhën ujore, nenstacionin elektrik dhe linjen elektrike. Ky Raport Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM - paraprake dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë, parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) Procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

Raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 (i ndryshua).

Për përgatitjen e raportit të VNM-se për projektin “*HEC QAM*”, Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, date 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (I ndryshuar), Neni 8: (Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis),

Shtojca II ; Pika 3 .Industria e energjisë ;

Germa ë) instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike

#### **Objektivat afatshkurtër të VNM paraprake janë:**

- Përmirësim nga pikëpamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

#### **Objektivat afatgjatë të VNM paraprake janë:**

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentët përbërës të ekosistemeve;

- Përmirëson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndhmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.
- **Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e projektit**

Për zgjidhjen e projektit “Ndërtim e hec –Qamit”. Teknologjinë e zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe mobilimin urbanistik të zonës të studiuar, projektuesit janë mbështetur në ligjislacionin mjedisor të miratuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret e ndryshme për mjedisin. Gjithashtu shoqëritë ndërtuese që do të zbatojnë punimet dhe projektin do të marrin përsipër të zbatojnë me korrektësi normat e përmirësuara në të ardhmen në drejtim të ndotjes së mjedisit. Në kuadrin aktual ligjor për VNM -në, kryesoret janë:

- **Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (I ndryshuar);**
- **Ligji Nr.9115, date 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” (I ndryshuar);**
- **Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” (I ndryshuar);**
- **Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (I ndryshuar);**
- **Ligji Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” (I ndryshuar);**
- **Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (I ndryshuar);**
- **Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”;**
- **Ligji Nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;**
- **VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” (I ndryshuar);**
- **VKM Nr.177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”;**
- **VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”;**
- **VKM Nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”;**
- **VKM Nr.123, datë 17.2.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”;**
- **VKM Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” (I ndryshuar);**
- **VKM Nr. 178, datë 6.3.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”;**
- **VKM Nr. 313, datë 9.5.2012 “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve”;**
- **VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”;**
- **VKM Nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”;**
- **VKM Nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”;**
- **VKM Nr. 47, datë 29.1.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”**
- **VKM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;**

- VKM 418, datë 25.6.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- VKM Nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”;
- VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B, dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” (I ndryshuar);
- VKM Nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;
- VKM Nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” (I ndryshuar);
- VKM Nr. 865, datë 10.12.2014 “Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara”;
- VKM Nr. 127, datë 11.2.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura”;
- VKM Nr. 360, datë 29.4.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre;
- VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- VKM Nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”;
- VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisit”;
- VKM Nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- VKM Nr. 372, datë 18.5.2016 Për miratimin e rregullave të komunikimit, konsultimit dypalësh dhe vendimmarrjes për lejen e mjedisit të tipit A, për funksionimin e instalimit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një shteti tjetër, ose menjëherë pasiI kërkohet nga ky shtet” (I ndryshuar);
- Udhëzim Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”;
- Udhëzim Nr. 4, datë 15.4.2013 “Për dokumentacionin e aplikimit për leje mjedisi të tipit A, B dhe C në Qendrën Kombëtare të Licensimit(QKL)”;
- Udhëzim Nr. 47, datë 29.1.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizmin dhe funksionimin e Agjensisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjensive Rajonale të Mjedisit”;
- Urdhër Nr. 321, datë 11.2.2014 “Për përfundimin e periudhës kalimtare, në kryerjen e funksioneve të dhëna, Agjensisë Kombëtare të Mjedisit, nga Ligji Nr. 10448, fatë 9.6.2011”Për lejet e mjedisit”;
- Urdhër Nr. 67, datë 11.3.2018 “Përmiratimin e veprimit për veprimtaritëminerare me karrierë(guroret)”;
- Rregullore Nr.6, datë 30.11. 2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.

**-Ligji Nr.10431, datë 09.06.2011, në nenin 26 të tij “Për mbrojtjen e mjedisit”**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

**-Ligji Nr.10 440, datë 06.06. 2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”**

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

- a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) garantimin e një procesi të hapur vendimarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Në të përcaktohen dhe natyra e procesit të shqyrtimit të VNM

- a) procesi i thelluar i VNM
- b) procesi i përmbledhur.

**Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis**

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) **procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**
- b) **procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**

3. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) **raporti paraprak i VNM-së**, për projektet e shtojcës II;
- b) **raporti i thelluar i VNM-së**, për projektet e shtojcës I.

Studimi përfshihet në Shtojcën II, “Projekte që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis –

Shtojca II ; Pika 3 .Industria e energjisë ;

Germa ë) instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike

**Vendimin Nr.686, datë 29.06.2015** "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore".

**Ligji Nr.10448, datë 14.06.2011,"Per Lejet e Mjedisit".**

Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Përcakton detyrimet për Pajisjen me Leje Mjedisore të subjekteve fizike dhe juridike që kërkojnë të ushtrojnë një veprimtari që ka ndikime në mjedis. Kreu IV i këtij ligji "Leja për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis" Nenet 35-48 përcaktojnë modalitetet e marrjes së lejes mjedisore.

**Ligji Nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"**

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisorë të mbetjeve nëpërmjet:

- a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve.
- b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre.
- c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

**Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të Mbetjeve të Ngurta".**

**Ligji Nr. 9115, datë 24.06.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur"**

**Ligji Nr.9664, datë 12.06.2006 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"**

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifikët mund të përmendim:

- Ligji Nr.9586, datë 20.06.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr. 8666, datë 05.04.2001, "Të mbrojtjes ndaj zjarrit".
- Ligji Nr. 9108, datë 16.06.2003, "Për substancat dhe preparatet kimike".
- Ligji Nr.9290, datë 06.10.2004, "Për produktet e ndërtimit".
- V.K.M. Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit".
- V.K.M. Nr. 435, datë 12.09.2002, "Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".
- V.K.M. Nr. 249, datë 24.04.2003, "Për dokumentacionin për Leje Mjedisore dhe të elementëve të Lejes Mjedisore".
- VKM Nr. 268, datë 24.04.2003, "Për çertifikimin e specialistëve, për V.N.M. dhe auditimin mjedisor".
- V.K.M. Nr. 166, datë 31.05.2005, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse".
- Udhëzimi Nr.429, datë 16.11.2009, i Ministrisë së Mjedisit, "Për rregullat dhe procedurat për paisjen me leje mjedisi në kuadër të Qendrës Kombëtare të Liçensimit".
- V.K.M.Nr.586, datë 06.06.2010, "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike".
- Udhëzimin Nr.8, datë 26.11.2006, "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara.
- Ligji Nr.8906 datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura i azhornuar me ligjin nr.9868 datë 04.02.2008

**Procedura e përgatitjes së Raportit të V.N.M-së**

Në shtojcën 1 dhe 2, të Ligjit Nr.10 440, datë 06.06. 2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, gjendet e listuar dhe veprimtaria për vlerësim. Për këtë arsye, në zbatim të V.K.M. Nr.249, datë 24.04.2003 “Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementëve të Lejes Mjedisore”, në Aneksin 1, në pikën 4 parashikohet dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili do të hartohet sipas procedurave të parashikuara në Ligjin Nr.10440, datë 06.06. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” dhe Vendimit Nr.686, datë 29.06.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore”.

Vlerësojmë se kjo veprimtari do të pajiset me **Deklaratë Mjedisore** për punimet ndërtimore dhe do t’i nënshtrohet procedurës së **Raporti Paraprak të VNM-së**, për projektet e shtojcës II;

## **b) Kuadri Ligjor Nderkombëtar**

### ▪ **Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës**

Marëveshje jo zyrtare IUCN bën vlerësimin e gjëndjes së ruajtjes së llojeve tëkafshëve/bimëve dhe përcakton nivelin e kërcënimit. Listat për statusin e llojeve të kërcënuar (Listat Kuqe e IUCN) janë publikuar për shtete të ndryshme. Lista e IUCN për llojet e kafshëve /bimëve të identifikuar si të kërcënuara jepen

### ▪ **Konventa ESPOO**

Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstndërkufitar Ratifikuar 25.02.1991. Kërkon që palët nënshkruese të kryejnë vlerësimin e ndikimit në mjedis të disa veprimtarive në një fazë të hershme të planifikimit dhe që shtetet të njoftojnë /konsultohen me njëri tjetrin për të gjitha projektet për të cilat mendohet se do kenë të kenë ndikime negative.

### ▪ **Konventa e Bernës**

Konventa për mbrojtjen e florës dhe faunës së egër mjedisit natyror në Europë.

Ratifikuar nga Ligj inr.8294, 2.03.1998

Për garantimin e ruajtjes /mbrojtjes së florës/faunës së egër dhe mjedist të tyre natyror, ritjen e bashkëpunimit midis palëve kontarktuase dhe nxjerjen e akteve regullatore për shfrytëzimin e specieve (dhe shtegtare)

### ▪ **FCM**

Marëveshja për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të peshkimit për Mesdheun.

Promovon zhvillimin ruajtjen dhe menaxhimin /përdorimin e përgjithshëm të burimeve detare në detin Mesdhe/ detin e Zi

### ▪ **Konventa e Aarhus-it**

Konventa për të drejtën për Informim, pjesëmarrje në vendimarrje, dhe të Ratifikuar Ligjinr.8672. 10. 07.1989 Garanton të drejtat e publikut për pjesëmarrje në procese vendimarrjeje të qeverisë për çështje që lidhen me mjedisin local.

### ▪ **Kuadri Ligjor European**

Raporti i VNM për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :



- **Direktiva 2000/60/CE** Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- **Direktivës KE 42/2001** (të Këshillit të Evropës), mbi VNM dhe VSM.
- **Direktiva 2001/42/CE** e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- **Direktiva 2009/28/CE** e parlamentit Evropian për Energjitë e Rinovueshme

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimit të projektit në mjedisin fizik dhe special. Ky proces zhvillohet brenda atij të planifikimit dhe zbatimit të projektit, duke paraqitur prioritetet mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Në vijim janë përshkruar vecorit kryesore të projektit, të cilat, së bashku me investigimet në vendndërtimin e parashikuar të ushtrimit të aktivitetit, kanë shërbyer për identifikimin e ndikimeve në mjedis të ndërtimit të “HEC QAM” - objekt i këtij vlerësimi.

Nga pikepamja e ndarjes gjeografike pellgu i Perroit të Serriqes ndodhet në krahinën malore lindore në perëndim të qytetit të Kukësit sipas klasifikimit gjeografik të vendit tone, nga Qendra e Studimeve Gjeografike, perroi i Serriqes ndodhet “në pjesën qendrore të krahinës malore veriore” Perroi i Serriqës, degë e Lumit Drin, ndodhet në Krahinën Malore Veriore. Ai ka një shtrirje, nga burimet fillestare e deri në derdhje në lumin Drin (Liq i Fierzes) rreth 20 km dhe me drejtim diagonal të rrjedhës nga jug-perëndimi në drejtim të veri-lindjes. Perroi ndodhet në administrim të qarkut të Kukësit, komuna Malzi. **Komuna Malzi** është një komunë në Rrethin e Kukësit. Pellgu ujëmbledhës i perroit të Serriqës në aksin në studim në kuotën **▼390 m** mbi nivelin e detit, formon një pellg ujëmbledhës prej **F=61.9 km<sup>2</sup>**. Aksi në studim ndodhet afërsi të fshatit Qam dhe ka një shtrirje gjatësore rreth 15 km që nga burimet fillestare.

### **Statusi i zones së studiuar dhe objektivi i projektit.**

Projekti i fizibilitetit të HEC “ÇAM” është hartuar nga Kompania Konsulente “**Zenit & CO**” Shpk, me porosi të kompanisë sipërmarrëse “**EKO ENERGY**” Shpk, bazuar në projekt idene dhe investigimet që janë bërë në terren të kësaj veprë dhe studimeve të tjera ndihmëse për Hidrologjinë, Topografinë, Gjeologjinë dhe Mjedisin. Në hartimin e projektit të fizibilitetit janë respektuar në përgjithësi të gjitha kriteret teknike, topografike dhe plan-vendosjes së veprave të këtij Hidrocentrali mbasi grupi i projektimit në shoqërimin e investitorit kanë bërë investigime në terren për të shqyrtuar skemën e shfrytëzimit me shumë rendiment për HEC-in e parë kjo në dy aspekte si në atë të prodhimit të energjisë por dhe të kostos sa më të ulët për ndërtimin e saj. Ndërtimi hidrocentralit është në përputhje me planet e zhvillimit ekonomik të vendit dhe nuk cenon aspak statusin dhe karakteristikat e zones. Në kufirin e poshtëm të territorit do të ndërtohet vepra e marrjes në shtratit të çveshur të lumit nga ku dhe fillon kanali i derivacionit. Nevoja për ndërtimin e ketyre hidrocentraleve brenda kondicioneve tekniko-mjedisore, për situatën që po kalon vendi ynë dhe rajoni, është nevojë imediate. Shoqëria “EKO ENERGY” Shpk ka angazhuar për llogaritë të saj grupet e specialistëve hidrologje, gjeologe, hidroteknike dhe topografe, të cilët pas disa rikoncioneve përkatëse në terren në një pjesë të lumit, njohjes me relievin topografik, me tipin e rrjedhjes ujore me prurjen e përgjithshme të tyre, si dhe me kushtet gjeologjiko-inxhinierike, kanë realizuar konceptimin e skemës së shfrytëzimit hidroenergjetik të Lumit të Serriqes në zonën e Kukësit.

**a) Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;**

Projekti që do të zbatohet është aktiviteti i ndërtimit të një HEC-I Qam. Kjo sipërfaqe ndodhet në zonën e Perroit të Seriqes, të Njesisë Administrative Qam, Bashkia Kukës. Terreni është kryesisht me reliev kodrinor dhe karakterizohet nga toke deluvionale, të cilat ndodhen pranë faqeve të maleve. Bimësia e zonës përbëhet kryesisht nga dushqe, halorët dhe kullotat alpine, ndërsa shkurret kanë përhapje të kufizuar, ato takohen në pjesën lindore dhe jugore të zonës. Shpatet veriore të zonës deri në lartësitë 1500- 1750 m janë të çveshura. Mbi këto lartësi, takohen pyje me pisha, ahë dhe bredhi. Në vetë sipërfaqen ku do të kërkohet leja e ndërtimit ka pyje shumë të rralla ose zona është e çveshur, si dhe nuk ka tokë bujqësore mbi të. Theksojmë gjithashtu se në këtë sipërfaqe nuk ka vepra arti, argjinatura dhe vepra hidroenergjitike. Bimësia që karakterizon këtë zonë janë kryesisht shkurre që ndodhen në fundin e shpateve të kodrave dhe në kodra, por nuk mungojnë edhe pemët e larta të llojit lisë, plepa, pisha dhe shelgje të cilët zhvillohen në zona të luginave ku është e zhvilluar mbulesa bimore. Gjithashtu, pjesërisht bimësia përbëhet edhe nga kulturat bujqësore të këtyre tokave dhe shumë pak pemë frutore. Në kodrat përreth përbëhet nga bimësi barishtore e shkurre e egër (shkurre mesdhetare). Kulturat bujqësore të zonës variojnë nga më të ndryshmet, duke përmendur drithërat, foragjeret, perimet, pemët frutore, vreshtat e rrushit, etj, por kuptohet që në sezona të ndryshme të vitit dhe në sasira tepër të vogla. Përsa i përket bimesisë së rajonit, për shpatet e kodrave që e kufizojnë këtë zonë, përmendim kumbulla, arra etj. Zona në fjalë historikisht ka qënë e mbuluar me shkurre të brezit mesdhetar para-malor ose malor si dhe me pyje të lartë të përbërë nga llojet e dushqeve (trungjishte dhe cungjishte). Ndër llojet e drurëve që kanë përbërë grumbujt pyjorë kanë qënë: Lisat, të përfaqësuar nga llojet: Bungë (*Quercus petraea* Liebl.), Qarr (*quercus cerris* L.), Bulgër (*Quercus trojana* Uebb.); Ndër llojet e pyllëzuar janë: Pisha e Zezë (*Pinus nigra* Arn.), dhe Pisha e Egër (*Pinus halepensis* Miller); gjenden gjithashtu Frashëri i Zi (*Fraxinus excelsior* L.), rrallë Panja e Malit (*Acer pseudoplatanus* L.) etj.. Ndërsa nga llojet shkurre më të përhapur të cilët marrin pjesë në përbërjet e mbulesave pyjore të sipërfaqja e synuar për ndërtim gjenden: Dëllënja e Kuqe (*Juniperus oxycedrus* L.), Shqopa e butë (*Erica arborea* L.), Voshtra e rëndomtë (*Ligustrum vulgare* L.); Krifsha (*Phillyrea media* L.). Në sipërfaqet e shpateve të pjerrët të cilët ka vepruar fenomeni i shplarjes sipërfaqësore përhapet lloji gjysëm-shkurre Mënishtja e pushtë (*Cistus villosus* L. ssp. eu-villosus Hay). Në shtratit e prroskës dhe në të dy anët e saj gjenden llojet: rrap (*Platanus orientalis* L.), Konopicë (*Vitex agnus-castus* L.), shega e Egër (*punica granatum* L. var. *sponda neum* K.Maly), ferra (*Rubus ulmifolius* Schott.), shelgu i kuq (*Salix purpurea* L.) etj.



FOTO TE BIMSISE

**Bimësia barishtore.** Nga hulumtimi floristik i bërë u vërejtën lloje barishtorë të familjes së graminoreve si dhe lloje bar-ndryshëm të cilët në përgjithësi luajnë rol anti-eroziv në procesin e shplarjes sipërfaqësore të tokës që po vazhdon në këtë vend. Mund të përmendim si gjini bimësh barishtore të identifikuar atë të llojeve: *Brachypodium sp.*, *Bromus sp.*, *festuca sp.*, *Plantago sp.*, etj.

**b) Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;**

Burimet ujore janë të pranishëm si ato nëntokësore dhe mbitokësore

Burimet nëntokësore gjykojmë sipas kompleksit ujembajtës nga studimi hidrogeologjik

Komuna Malzi shtrihet perëndim të Rrethit Kukës dhe ka një sipërfaqe prej 14506 ha me një terren pothuajse tërësisht malor dhe kodrinor..Sipërfaqja e përgjithshme përbëhet nga 8793 ha pyje dhe 2348 ha kullota, toke

bujqesore 1264 ha, livadhe 44 ha , inproduktive 1356 ha, shkembore 462 ha , siperfaqe e eroduar 162 ha , siperfaqe ujore 26 ha , pemtore 6 ha, troje 45 ha.

Shkembinjat nga pikpamja e ujmbajtjes ndahen

### **1. Kompleksi ujmbajtës në shkembinjat kompakt, me ujmbajtje mesatare jo uniforme.**

**Në këtë kompleks ujmbajtës kemi futur të gjitha depozitimet si më poshtë :  $T_{1-2}, T_1, dJ_2$ -  
Ultrabaziket,  $\sigma J_2(D), \sigma J_2(Lp), \sigma J_2(H), vPz$**

Shkembinjat e këtij kompleksi janë mjaft të perhapur në basenin tone. Këta shkembinjat perbehen kryesisht nga harzburgite, lercolite e dunitë, pak piroksenite dhe serpentinite. Këto shkembinjat janë të perhapura në forme masive të vecanta ose dalin në forme njollash të vogla në mes të shkembinjëve bazik. Në basenin tone kemi disa masive me rendesi të ndërtuar nga ultrabaziket të cilat janë : Masivi i Tropojës, I Krrabit, Kukësit, i Pukës, I Bulqizës. Këto shkembinjat janë të shoqëruar me carje të vogla të cilat shërbejnë si faktorë të ujmbajtjes së këtij kompleksi. Ujrat nentoksore që dalin nga ky kompleks nuk janë të shumta, ose më mirë të themi janë të shumta vetëm në kohën e shirave dhe të deborës. Kurse në kohën e thatësirës e paksojnë deri në shterrim të tyre. Shpërndarja e burimeve që janë takuar në këtë kompleks nuk është e njëllojtë për të gjithë masivet ultrabazike, kjo si rrjedhim i një sere faktorësh që influencojnë në ujmbajtjen e masivit (latesia e masivit, dendësia e carjeve, mbulesa e deborës etj.) Për këtë kompleks interes paraqet vetëm masivi i Krrabit ku kemi burime me debite  $Q=5-25$  l/s, uje nga ana kimike paraqite i mirë me këta tregues kimik :  $Mp= 0.25-0.35$  gr/l,  $pH= 7.5-8$ ,  $Fp= 8-10$  grade gjermane. Uji është brenda normave të ujit të pijshëm. Uji është i tipit Hidrokarbonat magneziumi  $HCO_3-Mg$ , rrallë Hidrokarbonat –kalciumi  $HCO_3-Ca$

### **2. Kompleksi ujmbajtës i shkembinjëve mesatare e mesatare-acide**

Shkembinjat e këtij kompleksi kanë përhapje të kufizuar dhe perbehen nga diorite kuarcore, plagjiogranite, mikrodiorite dhe granite. Këto shkembinjat shtrihen në forme masiveve të vegjël. Vetët hidrogjeologjike të shkembinjëve të këtij kompleksi nuk janë të mira, këto shkembinjat në siperfaqe janë mjaft të prishur si nga pikpamja fizike edhe kimike, pra janë të eroduar dhe të shpërlara në siperfaqe e me carje të shumta. ndërsa në thellsi të tyre ndodh e kundërta. Zonat e prishura shtrihen nga 10-15 m, më poshtë shkembinjat janë kompakt. Si rrjedhim në këtë kompleks takohen burime të vogla me debite që variojnë me  $Q=0.05-0.3$  l/s. Uji i këtyre burimeve ka këto tregues kimik  $Mp=0.06-0.3$  g/l,  $Ph 6.6-7.98$ ,  $Fp=1.09-9.5$  grade gjermane. Uji është i tipit Hidrokarbonat kalciumi e natrium- kalciumi  $HCO_3-Ca$ ,  $HCO_3-Na+K$

### **c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;**

Qëniet njerëzore kanë nevojë për ajër me cilësi të mirë për të pasur mirëqenie dhe për të qenë të shëndetshëm. Ajri është një përzierje e **azotit, oksigjenit, dioksidit të karbonit dhe disa gazeve të tjera inerte**. Gjithashtu, ai përmban sasi të ndryshueshme avujsh uji. Ajri përmban edhe shumë lëndë të rrezikshme: ndotës natyrorë të tillë si pluhuri dhe hiri vullkanik, si dhe ndotës që çlirohen nga aktiviteti njerëzor.

#### **Ndotja e ajrit në mjediset e jashtme**

Ndotja e ajrit (apo ndotja atmosferike) është një lloj i ndotjes i karakterizuar nga një ndryshim i nivelit të cilësisë së pastërtisë së ajrit. Degradimi i ajrit zakonisht është rezultat i kombinimit të një kokteji ndotës i cili përbëhet nga grimcat, apo substanca të tjera tek të cilat shkalla e përqendrimit dhe zgjatja e pranisë është e mjaftueshme për të prodhuar një efekt **toksik apo ekotoksik**. Përbërësit kimikë të pranishëm në atmosferë, kur

ndeshen jo në rrugë natyrore dhe në përqëndrime të larta, quhen ndotës të ajrit në mjedisin rrethues. Ata mund të jenë të rrezikshëm për mjedisin dhe shëndetin njerëzor . Ndotësit më të zakonshëm të ajrit janë:

- dioksidi i squfurit SO<sub>2</sub>,
- oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>),
- monoksidi i karbonit (CO)
- plumbi,
- grimcat e pluhurit (PM10 dhe PM 2.5)
- lëndët organike lehtësisht të avullueshme (VOC-ve).

Ndotësit e rrezikshëm të ajrit përfshijnë metalet dhe jometalet të tilla si:

- kadmiumi,
- zhiva
- arseniku;

Disa fibra minerale si

- asbesti
- mikro fibrat e qelqit;

#### **Gazet joorganike,**

të tilla si gazet me përmbajtje

- fluori,
- klori,
- cianidet
- fosgjenet;

#### **Lëndët organike të tilla**

- si aldehidat,
- hidrokarbonet aromatike
- aromatike policiklike (PAH)
- dioksinat.

Gjëndja e cilesisë së ajrit është një nga çështjet kryesore që shqetëson autoritetet lokale dhe kombëtare për impaktin që ka në shëndetin e popullatës ,bujqësisë dhe mjedisit në përgjithësi. Kushtet e jetesës së njeriut janë direkt të varur nga ekosistem në të cilin ai jeton, kështu që është e nevojshme për të mbrojtur dhe për të ruajtur mjedisin si dhe për të siguruar një cilësi të qëndrueshme të jetës për gjeneratat e tashme dhe të ardhshmen.

#### **Ndikimet ne biodiversitet**

Biodiversiteti është një nocion shumë kompleks që nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve në një rajon , ose shprehur ndryshe biodiversiteti paraqet llojllojshmërinë jetësore në tokë. Jeta e gjallë në tokë ka nivele të ndryshme të llojshmërisë duke filluar nga ADN-ja, llojet, popullacionet dhe ekosistemi. Sipas të dhënave shkencore në tërë botën deri me tani janë identifikuar 1.75 milion lloje.Por vlerësimet e përgjithshme të shkencës janë se ekzistojnë edhe miliona lloje të paidentifikuara, shumica e të cilave gjinden në vendet tropikale (vlerësohet se numri i llojeve mundë të jetë mbi 5 milion) Humbja e biodiversitetit si problem global.Biodiversiteti përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në bote.Është vlerësuar se rrjedha ne këtë trend e kërcënimit të

ekosistemeve natyrore do të paraqes rrezik për të ardhmen e njerëzimit dhe mund të sjell pasoja të rënda në natyrë. Ndonëse kanë kaluar 19 vite që nga nënshkrimi i Konventës ndërkombëtare për Biodiversitetin të mbajtur në Rio de Janeiro ku ndër parimet kryesore të miratuara ka qenë edhe “ruajtja e vitalitetit dhe shumëllojshmërisë biologjike të jetës në tokë dhe përdorimi racional i resurseve natyrore”, problemi i ruajtjes së biodiversitetin vazhdon të jetë edhe sot shumë i theksuar. Sipas të dhënave më të reja shkencore që nga vitit 1992 kur u mbajt Samiti i Rios, rreth 11.4 % e mjediseve të paprekura në botë janë ndryshuar nga njeriu. Supozohet se vetëm në 50 vitet e fundit, veprimet e njeriut kanë ndryshuar diversitetin e jetës në planet me tepër se çdo etape tjetër të historisë së njerëzimit. Të dhënat flasin se vetëm në 100 vitet e fundit, zhdukja e specieve e shkaktuara nga njeriu është shtuar rreth 1000 here. Po ashtu rreth 12 % e shpendëve, 23 % e gjitarëve, 25 % e haloreve dhe 32 % e ujë tokësorëve kërcënohen për zhdukje, ndërkaq që rezervat peshkore të botes janë reduktuar deri në 90 % që nga fillimi i industrisë së peshkimit. Ekspertet supozojnë se nëse do të vazhdohet me këtë trend , humbja e biodiversitetit do të ketë pasoja fatale për njerëzimin. Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25-30 viteve të ardhshëm do të zhduken deri në 10 % të llojeve të njohura në planet. Pasojat e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonomine botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40 % e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave të njeriut plotësohen nga resurset biologjike. Ekzistojnë shumë faktorë të cilët janë shkaktarë të zhdukjes së llojeve, por më të theksuarit janë:

- rritja e numrit të popullsisë në botë, shkalla e lartë e shpyllëzimit të sipërfaqeve të pyjeve,
- Tharja e moçaleve
- Zhvillimi i hovshëm industrial,
- Ngrohja globale,
- Shirat acidike etj.

Domosdoshmëria e ruajtjes së biodiversitetit

Ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shume arsye, por me këtë rast do të përmendim vetëm disa prej tyre:

- Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t’iu lemë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga para ardhësit tanë,
- Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri,
- Shume lloje bimore kanë vlera të jashtëzakonshme shëndetësore, andaj zhdukja e tyre do të thotë zhdukje e kësaj vlere,
- Proceset natyrore biologjike janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes së mjedisit të pastër dhe jetës në planetin tonë,
- Biodiversiteti dhe llojllojshmëria biologjike e natyrës paraqet një potenciale të larta për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të një vendi,
- Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike,
- Dhe mbi të gjitha vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varura nga biodiversiteti i shfrytëzimit të bimëve dhe kafshëve. theksuar se siperfaqja që do të shfrytëzohet është kodrinore malore



Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate shfrytezimit te objekteve , peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem do te krijohet nje ambjent panoramik i kendshem per syrin e njeriut dhe shlodhes. Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804. date 04.12.2003 dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146 ,date 08.05.2007 . Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne aktivitet te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet duke u pyllzuar. Ndersa per te menjanuar erozionin nga ujerat e rreshjeve atmosferike do te ndertohen kanale dhe kuneta qe ujerat te drejtohen ne zona qe nuk demtojne token,

### **Ndikimet në tokë**

Mjedisi eshte bashkesia e nderveprimeve te perberesve biotike dhe jobiotike qe nxisin dhe zhvillojne jeten e gjalle ne toke,duke perfshire mjedisin fizik, natyror te ajrit, tokes, ujerave etj. Faktoret natyrore dhe shoqerore te mjedisit ndikojne drejt perdrejt ne jeten e njeriut. Ata jane nje kusht thelbesor per te percaktuar zhvillimin e tyre fizik, mendor, Intelktual, psikologjik dhe vete menyres se jeteses se tyre. Nje njeri qe jeton ne nje zone te qete,ku ka shume gjelberim dhe pa gjelberimin e duhur. Njeriu qe jeton ne mjedisin e paster dhe te qete bene nje jete me normale dhe aktive se sa ai qe jeton ne nje mjedis te papaster. Per ti mbijetuar kohes njeriut I eshte dashur te pershtatet me mjedisin ku jeton dhe ta ndryshoje ate per tab ere sa me te pershtetshem per ekzistencen e tij. Ne kete pike shfaqen dhe problemet e para te mjedisit. Perparimi I kohes,zhvillimi i shkences dhe i teknologjise,shfrytezimi pa kriter I mjedisit krijuan problemet e para midis njeriut dhe mjedisit. Zhvillimi I teknologjise ka bere qe vetet jeta te permiresohet dhe njerezit te jetojne me mire por nga ana tjeter ka sjelle shume problem per mjedisin si p.sh. ndotja e ajrit, prerja e pyjeve etj. Mjedisi eshte shume I rendesishem prandaj cdo veprim I demshem mbi te do te mund ta demtonte ate dhe shendetin e vete njeriut. Per te pasur nje shendet te mire nuk mjafton vetem kujdesi per veten dhe nje diete e balancuar por gjithashtu edhe te pasurit nje mjedis te paster dhe te gjelberuar.Jo te gjitha njerezit e insitucionet veprojne njelloj ndaj mjedisit.Disa zhvillojne veprimtari mbrojtese ndersa te tjere e shfrytezojne ne menytrat me barbare ate. Ruajtja dhe kujdesi per mjedisin nuk eshte vetem nje detyrim shoqeror,por mbi te gjitha eshte dhe nje pergjegjesi individuale. Mjedisi eshte i te gjithëve dhe te gjithë duhet ta mbrojn e ate.Shoqeria si ne vendin tone ashtu edhe ne mbare boten po perballet me problem te medha qe lidhe me mjedisin si :ndotja,prishja e ekuilibrave te ekosistemeve, shfrytezimi pa kriter I burimeve natyrore etj.

### **Ndotja e mjedisit:**

Eshte futja e drejtperdrejte ose e terthorte e lendeve, vibracioneve, energjise, nxehtesise, rrezatimit, zhurmave te cilat e ndryshojne cilesine e mjedisit e te jetes.Toka ku ne jetojme dhe zhvillojme veprimtarite tona eshte mjaft e rendesishme.Pa te nuk mund te kete jete ashtu si dhe uji.Toka eshte e rrezikuar nga ndotja.Te njejtet faktore qe ndotin ujin e ajrin e ndotin edhe token.Nga ana tjeter toka eshte e rrezikuar edhe nga humbja e shtreses se siperme qe perdoret prej njeriut per zhvillimin e bujqesise,blegtorise. Humbja e saj vjen nga fenomeni i shpyllezimit, erozionit, ndryshimit te temperaturave etj. Nga shekulli XXI rritja e nevojave dhe kerkesat e njeriut ndaj mjedisit ka bere qe rezervat boterore te naftes,gazit natyror etj, te pakesohen. Disa shkencetare mendojne se shume prej

ketyre burimeve jan e ne rrezik zhdukjeje.Perdorimi me racionalitet I burimeve natyrore quhet ruajtje ose konservimi I tyre. Mineralet;jane perdorur gjate gjithe jetes se njeriut.Rezervat e disa prej mineraleve jane ne mbarim.Per te mbrojtur rezervat e tyre jane gjetur zevendesues si p.sh. ne vent e celikut perdoret betony,cimentoja etj. Lendet djegese: Me zhvillimin e industrise u rrit perdorimi ne menyre intensive I makinerive dhe makinave te transportit,qe kerkonin lende djegese si nafta,gazi natyror etj.Rezervat jane te kufizuare.Per te mbrojtur keto burime mund te perdoren nje sere menyrash si : perdorimi me kriter I produkteve si qymyri, burimet natyrore te perdoren me kujdes,pershtatja e politikave shtetere dhe ndershtetere me problemet e mjedisit dhe ruajtjen e tij,etj. Mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit konsiderohen si pjesa më e rëndësishme e jetës në planetin tonë. Te gjitha proceset qe çojnë në një sistem ekologjik te suksesshëm janë të lidhura me programin për përcaktimin e strategjisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të objektivave në ruajtjen e natyrës e të mjedisit. Ekologjia është themeli i ruajtjes se natyrës dhe të mjedisit dhe si shkencë e biologjisë shfrytëzon të dhënat shkencore të kimisë, të fizikës të matematikës dhe të shumë shkencave tjera. Dy janë drejtimet kryesore:

1. Ruajtja e mjedisit që ka si qëllim të kufizojë ndikimin e ndotjeve te industrisë, bujqësisë, transportit, ndërtimit e veprimtari te njeriut.
2. Ruajtja e natyrës që ka si qëllim të kufizojë deri ne minimum ndryshimet në natyrë (ekosistemet) siç janë efektet e ngrohjes globale, ruajtja e shtresës së ozonit, pakësimi i emetimit të gazrave, evitimi i shirave acide.Zhvillimi i aktivitetit nuk ka shkarkime ndotese ne toke

### **Ndikimet ne ujë**

Ndotja e ujit është ndotja e trupave ujqorë, zakonisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore.Organet ujore përfshijnë për shembull liqenet, lumenjtë, oqeanet, akuiferët dhe ujërat nëntokësorë. Ndotja e ujit rezulton kur ndotësit futen në mjedisin natyror. Për shembull, lëshimi i ujërave të zeza të trajtuara joadekuat në trupat natyrorë të ujit mund të çojë në degradim të ekosistemeve ujqorë .Nga ana tjetër, kjo mund të çojë në probleme të shëndetit publik për njerëzit që jetojnë në rrjedhën e poshtme. Ata mund të përdorin të njëjtin ujë të ndotur të lumenjve për të pirë ose banjë ose ujitje .Ndotja e ujit është shkak kryesor në të gjithë botën i vdekjes dhe sëmundjeve, p.sh.për shkak të sëmundjeve të mbartura nga uji . Ndotja e ujit mund të klasifikohet si ndotje e ujërave sipërfaqësore ose ujërave nëntokësorë. Ndotja detare dhe ndotja e lëndëve ushqyese janë nëndegë të ndotjes së ujit. Burimet e ndotjes së ujit janë ose pika burimore ose pika joburimore.Pikat burimore të ndotjes kanë një shkak të identifikueshëm të ndotjes, siç është një kullim stuhie ose një impiant për trajtimin e ujërave të zeza.Pikat joburimore janë më të përhapura, siç është rrjedhja bujqësore.Ndotja është rezultat i efektit kumulativ me kalimin e kohës.Të gjithë bimët dhe organizmat që jetojnë në të ose duke u ekspozuar ndaj trupave të ndotur të ujit mund të ndikohen.Efektet mund të dëmtojnë speciet individuale dhe të ndikojnë në bashkësitë natyrore biologjike në të cilat bëjnë pjesë.Shkaqet e ndotjes së ujit përfshijnë një gamë të gjerë të kimikateve dhe patogjenëve, si dhe parametrat fizikë.Ndotësit mund të përfshijnë substanca organike dhe inorganike.Temperaturat e ngritura gjithashtu mund të çojnë në ujë të ndotur.Një shkak i zakonshëm i ndotjes termike është përdorimi i ujit si ftohës nga termocentralet dhe prodhuesit industrial. Temperaturat e ngritura të ujit ulin nivelin e oksigjenit, të cilat mund të mbysin



peshqit dhe të ndryshojnë përbërjen e zinxhirit ushqimor, të zvogëlojnë biodiversitetin e specieve dhe të nxisin pushtimin nga speciet e reja termofilike. Ndotja e ujit matet duke analizuar mostrat e ujit. Mund të bëhen teste fizike, kimike dhe biologjike. Kontrollimi i ndotjes së ujit kërkon infrastrukturë të përshtatshme dhe plane menaxhuese. Infrastruktura mund të përfshijë impiante për trajtimin e ujërave të zeza. Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe impiantet industriale të trajtimit të ujërave të zeza zakonisht kërkojnë për të mbrojtur ujërat nga ujërat e zeza të patrajuara. Trajtimi i ujërave të ndotura bujqësore për ferment, dhe kontrolli i erozionit në vendet e ndërtimit gjithashtu mund të ndihmojnë në parandalimin e ndotjes së ujit. Zgjidhjet me bazë natyrën janë një qasje tjetër për të parandaluar ndotjen e ujit. Kontrolli efektiv i rrjedhës urbane përfshin zvogëlimin e shpejtësisë dhe sasisë së rrjedhës. Në Shtetet e Bashkuara, praktikat më të mira të administrimit për ndotjen e ujit përfshijnë mënyra për të zvogëluar sasinë e ujit si dhe për të përmirësuar cilësinë e ujit. Ndotja e ujit është një problem i madh global që kërkon vlerësim të vazhdueshëm dhe rishikim të politikës së burimeve ujore në të gjitha nivelet (ndërkombëtar për akuiferët dhe puset individuale). Aktualisht është sugjeruar që ndotja e ujit është shkaku kryesor i vdekjeve dhe sëmundjeve në të gjithë botën. Ndotja e ujit shkaktoi vdekjen e rreth 1.8 milion njerëzve vetëm në vitin 2015. Në procese teknologjike të shfrytëzimit të hekur nikelit do të përdoret uji. Aktiviteti do të prodhojë Fe-Ni i cili do të shërbejë si lende e pare në industrinë e prodhimit të celikut dhe nikelit. Ujërat e shiut do të sistemohen përmes hapjes së kuletave dhe kanaleve për drenazhim dhe disiplinimin e ujërave të rreshjeve atmosferike.

### **Ndikimet në ajër**

Zhvillimi i aktivitetit do të sjell emetime të pluhurave në mjedis gjatë funksionimit sepse kemi levizje të makinave të pa shtruara, burime të tjera ndotëse për ajrin do të ketë nga gazrat dhe aromat e gatimeve të ndryshme. Pajisjet që do të përdoren për furnizim transport të njerëzve do të jenë bashkohore dhe në gjendje të mirë teknike në mënyrë që të shmangin emetimet nga djegia e lendeve djegëse që ato përdorin. Leshimi i aromave të guzhines është i pa shmangshëm prandaj është ndërtuar një oxhak mbi katin e sipër të ndërtësive duke i dërguar me aspiratorin e stufes së gatimit. Ndersa persha i përket vibrimeve ato janë të pandjeshme në zonat e banuara. Mëqenëse do të përdoren në procesin e shfrytëzimit të lendeve të demshme, si ujë termal do të ketë shkarkime të lendeve kimike të demshme për mjedisin në ajër, tokë dhe ujë. Ushtrimi i aktivitetit në këto sipërfaqe nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokës bujqësore. Tokat bujqësore ndodhen jashtë zonës ku do të kryhet aktiviteti. Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit janë ndikime direkte në mjedis.

1. Derdhja pa dashje e vajrave dhe naftë, graso nga mjetet e punës. Behet fjalë për ndonjë rast të rrallë të rrjedhjes gjatë difekteve dhe çarje të tubave dhe sotokartit të mjeteve
2. Shkarkimi i gazeve në sasi minimale nga lenda djegëse. Sasia e gazeve nga djegia e karburantit që do të shkarkohet nga mjetet motorrike. Është standart i teknologjisë së prodhimit të mjeteve dhe i karburantit. Gjithashtu do shlirojnë gazra nga ujërat termal
3. Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive të minierës. Vlerat standart të emetimit të zhurmave sipas teknologjisë së prodhimit të makinerive, kontroll teknik të makinerive

#### 4. Shqetësim i mundeshëm i faunes. Ndikim i perkohshëm.

##### **Masat e nevojshme për menaxhimin dhe reduktimin e ndotjes së ajrit në Shqipëri janë:**

- ❖ Reduktimi i numrit të automjeteve që qarkullojnë në zonat urbane të vendit tonë
- ❖ Përmirësimi i transportit publik
- ❖ Menaxhimi i rrjetit rrugor
- ❖ Promovimi i teknologjive të pastra të automjeteve
- ❖ Përdorimi i metodave inkurajuese për përdorimin e transportit publik ndaj atij privat.
- ❖ Promovimi i përdorimit të biçikletave.
- ❖ Përmirësimi i kontrollit të cilësive së lëndës djegëse për automjetet
- ❖ Përmirësimi i kontrollit teknik të automjeteve
- ❖ Reduktimi i emetimeve nga ndërtimet , konstruksionet urbane,
- ❖ Vlerësimi i ndotjes në stacionet e monitorimit

##### **Masa Zbutëse Specifike**

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale (të gjitha bashkitë të kenë dy- tre stacione monitorimi sipas specifikës së zonave industriale dhe të banimit)
- Koordinimi midis institucioneve Qëndrore dhe vendore për vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e ajrit dhe me masat ndaj ndryshimeve klimatike
- Gjatë fazës së ndërtimit, masat më të zakonshme specifike të rekomanduara në punimet infrastrukturore e kompleksit konsistojnë në:-Implementimi i sistemit të shtypjes së pluhurit: ujitja e anëve të rrugëve, përdorimi i ndarjeve të rrugëve për të kufizuar nxjerrjen e pluhurit (për shembull përdorimi i larjes së rrotave, gjë që behet përditë);
- Kufizimi i shpejtësisë së impianteve të lëvizshme në rrugë. Ulja e ndikimit nga ndërtimi përfshin gjithashtu: vendosjen e potenciale të zonave rrugët e transportit që përdoren për shpërndarjen e materialeve.
- Përsa i përket fazës së shfrytëzimit të infrastrukturës propozohen masat specifike të mëposhtme: kontrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve gjatë sezonit me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit me grimcat pezull në qendrat kryesore urbane; dhe mirëmbajtje e rregullt e sipërfaqeve rrugore për të pakësuar sa më shumë që të jetë e mundur ringritjen e pezullive
- Në zona individuale pritet një nivel më i lartë ndotjeje mjedisore gjatë fazës së ndërtimit dhe me tej gjatë fazës së operimit. për këtë, masat zbutëse do të duhet të realizohen gjatë fazës së ndërtimit, vecanërisht mbikqyrja e shkarkimeve të përshkruara prej makinerive të ndërtimit, vendosja e një kohe të limituar për ndërtimin dhe nese nevojitet zbatimi i masave për të parandaluar zhurmën të përhapet në mjedis. Impaktet gjatë fazës operationale do të jene afat-gjate. Si rregull, projektet me shtrirje të gjërë ose si korridore (rruge, linja tubacionesh, shtylla elektrike, etj.) nënkuptohet kanë impakt më të madh mbi mjedisin dhe në mënyre direkte përgjatë korridoreve, por në të njëjtën kohë mund të zbuten me ridrejtimin e aktiviteteve. Ato bëjnë të mundur të pakësojnë impaktet lokale sidomos aty ku densiteti i popullsisë është i lartë. Në përputhje me legjislacionin mbi mbrojtjen nga zhurmat, kushtet e mëposhtme mund të aplikohen gjatë fazës së operimit të strukturave të reja në infrastrukturë.

- Një burim i ri zhurme nuk duhet të prodhojë ndotje përtej kufirit të lejuar të zhurmes në mjedis;
- Një burim i ri zhurme nuk duhet të rrisë ndotjen nga zhurma, në një zonë ku zhurma ishte tashmë përtej kufirit të lejuar, përpara se të vendoset ky aktiviteti i burimit të ri;
- Masat e mbrojtjes nga zhurma duhet të garantojnë parandalimin dhe pakësimin e zhurmës që vjen nga përdorimi ose operimi i një burimi në mjedis.
- Nga aspekti i mbrojtjes prej zhurmave, këto masa mbrojtëse të referuara në legjislacion duhet të përdoren për të pakësuar ndotjen nga zhurmat në të gjitha aktivitetet e pritshme për të ulur dhe mbajtur më poshtë se niveli ligjor i përcaktuar. Zbatimi i masave të mëtejshme shtesë për mbrojtjen nga zhurmat do të jetë i nevojshëm në zonat e qendrave të mëdha urbane dhe korridoret e lidhjeve të infrastrukturës.
- Politikat sektoriale për masat e veprimit do të bëjnë të mundur gjithashtu indirekt lehtësimin e situatës ekzistuese që do të rezultojë në pakësimin e ndotjes nga zhurmat në zonat kryesore të transportit, në rrjetin e autostradave dhe në qendrat kryesore

### **Ndotja e ujit**

Niveli i ujrave nëntokësorë është i tillë që nuk është prekur nga gërmimet në kanalën e hapur për ndërtimin e ujisjellesit që do të çojë uji në Qendren Kurative Termale “BEQIRI” .

### **Ndotja e tokës**

Toka do të ndotet vetëm nga ndotjet aksidentale , nga derdhjet e karburanteve . Në rast se do të kemi derdhje ajo tokë do të hiqet dhe dërgohet në landëfillet e inerteve

## **ç ) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.**

### **Ujrat e ndotura**

Uji do të përdoret për shërbimin në godinën e HEC-it janë ujëra të ndotura. Për shkarkimin në kanalën e ndërtuar ato behen në gropën dekantimi të njëpasnjëshme. Ujërat e shiut do të sistemohen përmes kanaleve perimetrike dhe më pas do të bashkohen në mjedisin e ujit të pijshëm. Ujërat e larges në dush dhe banjë do të jenë me gropë dekantimi. Theksojmë se ujërat nuk përmbajnë elemente kimike të ndotjes.

### **Gazrat**

Pajisjet që do të përdoren për shërbimet do të jenë bashkohore dhe në gjendje të mirë teknike në mënyrë që të shmangin emetimet nga djegia e lendeve djegëse që ato përdorin. Ky aktivitet do të kryhet në zonat e banuara. Aktiviteti i shfrytëzimit të vendburimit do të bëhet në një zonë të kufizuar në krahasim me sipërfaqen dhe popullsinë e rajonit

### **Pluhri**

Zhvillimi i aktivitetit do të sjellë emetime të pluhurave në mjedis gjatë shfrytëzimit të HEC-it , burime të tjera të ndotjes për ajrin do të ketë dhe aroma .

## **Ndikimi nga zhurmat ne fazen funksionale te aktivitetit**

Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe .Çdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit. Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.Paisjet e makinerit qe do perdoren ne kete aktivitet do plotesojne direktiven 2000/1/14/CE te Parlatmetit Evropian dhe e KE 8 maj 2000, do jene te standartit te aplikueshem ne BE per zhurmat. Nga matjet e bera vleresojme se niveli akustik i zhurmes eshte bredna normave te miratuara sipas udherit Nr.8 Fenomene te tilla si vibracion, ndricim, nxehtesia jane te paperfillshme ne zhvillim te ketij aktiviteti ne kete objekt. Siç thame edhe me siper, zhurmat qe do te krijohen gjate procesit te punes ne objekt jane vetem ato te shkaktuara nga makinerite

## **Mbetjet**

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen.Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia e Kukësit para ndarjes territoriale).Edhe në këtë territor shërbimi ofrohen në nivelin 60-70%.. Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Kukësit , jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km<sup>2</sup>.Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg.Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Kukësit.Sasia e gjeneruar në zonën urbane të qytetit të Kukësit arrin në vlerën 851 -1605 ton/vit për km<sup>2</sup>. Ndotja që iu shkaktohet ujërave nëntokësore nga mbetjet urbane është e lartë për shkak të depërtimit të lëngut të ndotur të mbetjeve nga vend depozitimi (jo sanitar) i vendosur pranë shtratit të lumit, pra në zonën ku akuiferi afrohet maksimalisht me sipërfaqen e tokës. Po ashtu, shpimet për puse dhe gropa septike në territor ul nivelin e filtrimit të ndotjes para mbërritjes në shtresat nëntokësore dhe rritin ndotjen në ujërat nëntokësore. Riciklimi i mbetjeve Bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e Bashkisë Kukësit është përafërsisht 75 %, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 46.5%, 14.3% plastika dhe 13.4% letra. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin e këtij procesi.

## **Ndotja nga mbetjet e ngurta**

Mungesa e menaxhimit të duhur të grumbullimi të mbetjeve të ngurta dhe sistemi i menaxhimit dhe hedhja e madhe e mbeturinave po ndosin lumin me shumë mbetje, më shumë në formën e qeseve dhe shisheve plastike. Kjo shton nutrientët dhe ndotësit e tjerë në lum , prish pamjen vizuale dhe zbeh vlerat turistike të zonës dhe mund të bllokojë dhe shkatërrojë pompat e ujit.

## **Ndotës të tjerë**

Ndotës të tjerë të cilët mund të kërcënojnë ekosistemin e perroit përfshijnë pesticidet bujqësore, derdhjen e lëndëve djegëse në rrugë të cilat futen në perua , antibiotikët dhe barnat e tjera që përdoren në akuakulturë.Në zonën e studiuar cilësia e ujrave ka treguar se, për arsye të ndotjeve të shkaktuara nga industria e ndërtimit, ujrata nuk janë të pastër. Punimet për zbatimin e projektit “**Ndërtim të HEC-it** “ (Prodhim Betoni, Depozitim Inertesh) mund të ndikojë në këto ujra nëqoftëse gjatë punimeve të gërmimit për krijimin e bazamenteve të objekteve, mund të rrjedhin ujrata e përdorura në brendësi të ujrave të kanalizimeve të ujrave të zeza, të zonës në zhvillim ose ujrave sipërfaqësorë, sidomos në kohë shiu. Shoqëria e ndërtimit para vënies në shfrytëzim të objektit duhet të ketë ndërtuar gjithë rrjetin e tubacioneve e kanalizimit të objektit dhe të ketë riparuar difektet

që mund të dalin gjatë punimeve. Për këtë, shoqëria ndërtimore, që do të marrë përsipër kryerjen e punimeve ndërtimore për realizimin e projektit duhet që në plan-organizimin e punimeve të parashikojë;

1. Disiplinimin e ujrave të territorit rreth pronës, që në fillim të punimeve ndërtimore
  2. Largimin e ujrave të përdorura nga territori çdo ditë
  3. Betonet, për arësye të sasisë së tyre, do të vinë të gjithë të gatshëm në objekt për të eliminuar ujrat e ndotura nga betonet dhe llaçet.
  4. Mbetjet e betoneve brenda në makineri nuk duhet të shkarkohen në sheshin e ndërtimit të objektit.
- **Cilësia e ajrit në zonën e studiuar**

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, **LNP, PM10, NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, Pb, O<sub>3</sub>, CO dhe BTEX** përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të reflektuara edhe në VKM nr 803, datë 6.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit ". Monitorimi i ajrit për punimet e ndërtimit, është realizuar me pajisje automatike, për indikatorët e gaztë NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub> . Monitorimi i pluhurave (PM10) duhet të realizohet 24 orëshe. Në punimet ndërtimore për realizimin e projektit, ajri do të ndikohet nga pluhurat që do të krijohen gjatë punimeve të prishjes së objekteve ekzistues dhe procesit të ndërtimit të objekteve, por edhe gjatë proceseve të tjera ndërtimore. Pluhurat do të përhapen në zonë dhe mund të bien në bimësinë dhe objektet e tjera pranë zonës të njësisë Administrative Tregan fshati

### **Transporti urban dhe ai privat**

Transporti mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban. Gjatë punimeve për "Ndërtimin e HEC-it ", numri i automjeteve në zonë do të rritet. Ato do të jenë në lëvizje të vazhdueshme në sheshin e ndërtimit, sidomos gjatë transportit të dherave dhe betonet nga punimet e prishjes së shtresave të betonit. Këto makineri nuk do të ketë ndikim të ndjeshëm në ajrin e zonës pasi sasia e tyre do të jetë e vogël dhe nuk mund t'i kalojë 4 automjete në orë. Është e domosdoshme që të merren të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e sipërfaqes ku realizohen punimet e ndërtimit, për vajrat që mund të derdhen nga makinat e përdorura duke i parkuar ato në vende të caktuara dhe të mbrojtura mirë, si dhe larg rrugës kryesore të zonës, buzë së cilës do të zhvillohet projekti i ri.

**Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit** Në sektorin e ajrit janë identifikuar katër qëllime kryesore. Dy prej tyre kanë lidhje me pakësimin afatshkurtër të ndotjes së mjedisit. Ndërsa qëllimet e mëtejshme janë kritike për vazhdimin e mbrojtjes së ajrit, dmth grumbullimi i të dhënave mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe një sistem i planifikimit dhe kontrollit që do të sigurojë arritjen e objektivave të cilësisë së ajrit në një periudhë afatgjatë. Për sa i përket nivelit të zhurmave në zonën ku do të ndërtohet, tani për tani janë të ndjeshme për arësye të vendodhjes së objektit në zonë buzë rruge dhe me shumë trafik. Parametrat e zhurmave janë standarte të prodhimit të makinerive që punojnë në fushën e ndërtimit.

### **Administrimi i mbetjeve nga zbatimi i projektit**

Sipas preventivit të hartuar, sasia e mbetjeve inerte që kanë dalë nga punimet e projektuara për ndërtimin e ndërtimit të HEC-it është 4200 m<sup>3</sup>. Nga këto 3200 m<sup>3</sup> janë përdorur për për nivelim. Mbetjet e ngurta urbane që janë krijuar gjatë zbatimit të projektit, do të jenë të pakta dhe përfshijnë vetëm mbetjet që janë krijuar nga punonjësit që realizojnë proceset e ndërtimit të HEC-it. Mbetjet e ngurta urbane, rreth 4-5 kg/ditë, fillimisht

do të grumbullohen brenda territorit që zhvillohet sipas projektit të planifikuar nga projektuesit, plan - vendosjes së pikës së grumbullimit të mbetjeve urbane që është miratuar nga Bashkia Kuks. Ato do të largohen çdo ditë nga firma e ndërtimit sipas kontratës që do të lidhë ajo me Bashkinë për në fushën e mbetjeve të ngurta urbane. Sasia e gjenerimit të mbetjeve të specifikuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" janë si vijon:

- Dhera dhe gurë - **kodi 20 02 02** nga procesi i hapjes së themeleve të veprave të ndërtimit të HEC-it
- Mbetje rërash dhe argjilash - **kodi 01 04 09** nga procesi i nivelimit të sheshit që zhvillohet si dhe nga procesi i ndërtimit të themeleve të objekteve.
- Mbetje rërash - **kodi 01 04 08** nga procesi i punimeve të betonimit
- Materiale metalike dhe konstruksione metalike që dërgohen si skrape në K.M për tu shkrirë për hekur dhe çelik, - **kodi 17 04 05**
- Betone - **kodi 17 01 01**, që dalin nga mbetjet e punimeve të betonit dhe që riciklohen pjesërisht për tu përdorur si material mbushës në shtresa rrugësh.
- Mbetjet e përziera urbane (letër, karton, qelq) **20 01 01; 20 01 02.**

### **Trajtimi i mbetjeve.**

Mbetjet inerte të krijuara nga gërmimet për krijimin e bazamenteve, duke qenë se janë të përziera me zhavore të madhësive të ndryshme do të përdoret për mbushje dhe rievim të territorit gjatë procesit të ndërtimit. Një pjesë e tyre riciklohen. Kjo sasi e dherave mund të reduktohet vetëm nëqoftëse bëhet riciklimi i gurëve që mund të jenë të përzier me dherat.

**Dheu** i përzier me gurë, i dalë nga gërmimet është planifikuar që të largohet nga territori i objektit. Ai do të hidhet si mbetje ndërtimore.

**Materiali gurë** që do të dali nga gërmimet e sheshit do të tërhiqet nga firma ndërtimore dhe pas trajtimit në poligonin e inerteve, do të riciklohet, përpunohet në inerte për t'u përdorur në objekte të tjera si material i parë ndërtimor.

**Mbetjet e rërës dhe granilit** mund të krijohen gjatë punimeve të ndryshme të suvatimeve, muraturës dhe punimet e shtresave në objekt. Rëra, gurët dhe zhavori që do të teprojnë në objekt do të largohen dhe do të përdoren në objekte të tjera nga subjekti ndërtues, me të cilën investitori ka lidhur kontratë për realizimin e punimeve ndërtimore.

### **Mbetjet që do të krijohen gjatë funksionimit të objektit**

Gjatë funksionimit të HEC-it mbetjet që krijohen janë:

1. **Mbetje të qelqit- 20 01 02** (shishe, kavanozë, gota të thyera ose jasht përdorimit etj).
2. **Mbetjeve të letrës dhe kartonit-20 01 01** ( që mund të jenë qese ambalazhi, kutia kartoni etj.)
3. **Metalike -20 01 40** (kuti metalike vaji, e tj.)
4. **Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat -20 01 08**
5. **Detergjent për pastrim të ambjenteve të hotelit dhe vaskat -20 01 30**
6. **Plastike- 20 01 39** (qese, shishe plastike, kova dhe materiale të tjera plastike që duhen për shërbimin në objektin e zyrave dhe magazinave)

**7. Mbetjet e përziera urbane -20 03 01** që do të krijohen nga personeli punonjës, do të largohen çdo ditë për në fushën e mbetjeve urbane, sipas kontratave që do të ketë shoqëria me Bashkinë.

Në objekt do të vendosen kontenierë me ngjyra të ndryshme, për mbetjet e letrës, plastikës, shisheve të ndryshme dhe mbetjeve të ngurta urbane. Sipas një grafiku të përcaktuar nga firma, në bashkëpunim me Bashkinë dhe me kontraktuesit në vend të subjekteve që merren me riciklimin dhe grumbullimin e mbetjeve, ato do të tërhiqen nga vendi i përcaktuar brenda pronës që zhvillohet. Mbetjet inerte që mund të krijohen nga ngrirjet e betonit në betoniera do të largohen si mbetje inerte ose do të përpunohen për tu përdorur përsëri në fushën ndërtimore. Gjatë kryerjes së punimeve për realizimin e projektit investitori i objektit dhe shoqëria ndërtimore që ka marrë përsipër punimet ndërtimore do të ketë parasysh pikat e mëposhtme të këtyre ligjeve:

1. Ligji Nr. 31ë2013 "**Për disa ndryshime dhe shtesa në NR. 10 431, datë 9.6.2011 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT"**" neni 66, në pikat përkatëse:

**Pika 5.** Masa administrative e njoftimit për pezullimin e veprimtarisë, sipas këtij neni, është masë urgjente dhe mund të jepet krahas masave të tjera të nevojshme, në përputhje me ligjin për inspektimin". Kjo masë mund të merret ndaj investitorit në rast se ai nuk zbaton ligjet dhe VKM për mbrojtjen e mjedisit

1. **Vendim-i-KM\_565\_24.06.2015 "PER MIRATIMIN E KERKESAVE PER MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE"** investitori i objektit dhe shoqëria ndërtimore që ka marrë përsipër ndërtimin e objektit do të ketë parasysh pikat e mëposhtme:

**Pika 6.** Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t'i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.6.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen ngaëapo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Firma që do të zbatojë punimet për ndërtimin e objektit do të lidhë kontratë me firmën e paisur me licencë III.2B për transportin e mbetjeve jo të rrezikshme. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t'i ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitim të përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 361, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme", si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

**Pika 10.** Subjekti fizikë juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 4% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së. Për plotësimin e kësaj pike, pronarët dhe zhvilluesit e pronës, në bashkëveprim me Bashkinë Elbasan do të depozitojnë pranë saj shumën e lekëve deri 3 % të vlerës së preventivit të objektit, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak të qytetit të Elbasanit , në momentin e hartimit të proces -verbalit të fillimit të punimeve në objekt.

**Pika 11.** "Zotëruesi i mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitim të përkohshëm ose lëndfillët e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për tonëmbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore".

Në zbatim të VKM. 229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme",

Veprimtaria ndërtimore për realizimin e objektit "ndërtim HEC-i" nuk krijon mbetje të rrezikshme. Por në rast se do të krijohen aksidentalisht mbetje të gomave ose të vajrave të makinave, me pasoja ndotje të tokës ose ajrit, ato do të trajtohen dhe do të transferohen po me të njëjtën kompani për në vendin e caktuar nga Bashkia Kukës, ose në operatorët që merren me trajtimin e këtyre mbetjeve. Dokumenti i dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme do të shoqërojë çdo dorëzim të këtyre mbetjeve deri në destinacionin përfundimtar dhe të dhënat do të rregjistrohen në Rregjistrin Individual që krijohet për këtë qëllim. Këto dokumente do të përdoren për të gjithë materialet e rrezikshme që krijohen nga procesi funksionimit të objekteve

### **Gjithashtu investitori do të ketë parasysh që;**

Ndalohen:

- a) hedhja apo propozja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike;
- b) hedhja apo propozja e të gjitha llojeve të mbetjeve në parcelat bujqësore të mbjella ose jo, në anë të kanaleve kulluese e ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bima dhe kafsha;
- c) hedhja apo propozja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore;
- ç) djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve në kundërshtim me këtë ligj;
- d) braktisja, depozitimi apo asgjësimi i pakontrolluar i mbetjeve.

### **Ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve**

1. Mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, për të lehtësuar ose për të përmirësuar cilësinë e riciklimit në të gjitha rastet, kur një gjë e tillë është praktikisht e mundur nga ana teknike, mjedisore dhe ekonomike dhe kur kjo ndihmon që të plotësohen standardet e cilësisë për sektorët përkatës të riciklimit.

### **Mbetjet nga gomat e përdorura (nëse ka)**

1. Gomat e përdorura përfshijnë gomat që mund të ritregtohen, me qëllim përdorimin origjinal të tyre, edhe nëse do të jetë e nevojshme do t'i nënshtrohen trajtimit të tyre.
2. Gomat e patregtueshme do të riciklohen nëpërmjet grirjes së tyre dhe përdorimit të granulave si lëndë e parë për industrinë e prodhimit të gomave, ose do të dërgohen tek operatorët që të përdoren si lëndë djegëse shtesë për veprimtari të caktuara industriale.
3. Nuk lejohet në asnjë rast djegia e mbetjeve të gomave në mjedise të hapura.

### **Problemet e tjera : si erozioni i tokës, zjarret, etj.**

**Erozioni.** Vendi ku do të zbatohet projekti "Ndërtim HEC-it", nuk paraqet rrezikshmëri për erozion sipërfaqësor, për arsye të sheshtësisë së terrenit ku ndërtohet.

Masat që do të të merren gjatë kryerjes së punimeve ndërtimore:

- Do të eliminohet çdo lloj derdhje të ujrave sipërfaqësorë gjatë periudhës ndërtimore
- Realizimi i pusetave për grumbullimin e ujrave të shiut dhe largimi i tyre me pompë nga sheshi i ndërtimit ose gropa e thmeleve që mund të mbushet në rast shiu.
- Vendosja dhe përfundimi i armaturës së dërrasës për bazamentin e mureve betonarme.
- Montimi i sistemit të MKZ. në gjithë territorin që ndërtohet brenda dhe jashtë objekteve.



## d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;

### Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis

Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mirë ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga elementet e përshkruar më sipër, subjekti ndërtues, nëpërmjet personelit të tij do të përpilojë dhe do të zbatojë një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedis. Përmbajtja e këtij plani mbështetet në këto parime të zbatueshme.

### Vlerësimi i ndikimeve në fazën e ndërtimit

Vlerësimet e ndikimeve në fazën e ndërtimit mund të ndryshojnë me atë të fazës përgatitore dhe instalimit të teknologjisë, megjithatë disa lloje ndikimesh, pasojat dhe receptoret e këtyre ndikimeve janë të njëjta me ato të fazës përgatitore psh. emetimi i pluhurave. Ky ndikim është i njëjtë nga pikepamja cilësore por ndryshimi në fazën e ndërtimit të objektit qëndron në aspektin sasior të tij si psh kohëzgjatja e ndikimit, ekspozimi ndaj tij që lidhet dhe me hartën e transportit jashtë objektit, vlera e ndikimit apo sinjifikanca e tij. Më poshtë janë listuar ndikimet e identifikuar të veprimtarisë në fazën e ushtrimit të saj.

Tabela e identifikimit dhe vlerësimit të ndikimeve të veprimtarisë në fazën e ndërtimit

Lloji i ndikimit		Pasoja në receptor
1	Gërmimi i shtresave të tokës	Ky është një ndikim i pashmangshëm që përbën edhe qëllimin e veprimtarisë së propozuar për ndërtimin
2	Emetim zhurmë, gazesh, arome, vibracion dhe pluhuri	Si pasojë e gërmimeve që do të realizohen në objekt dhe e operacioneve të makinerive të gërmimit dhe transportit. Do të kombinohen dhe merren masa për të minimizuar ndikimet. Sasi minimale pluhuri do të hidhet mbi bimësinë në afërsi të objektit dhe që faktikisht është e varfër. Po kështu vlera të caktuara minimale vibracioni do të prekin disa lloje floristike që gjenden në zonë dhe në afërsi të saj. Një ndikim i cili vlen të merret në analizë dhe propozohen masa për zbutjen e tij është edhe efekti i zhurmës së krijuar nga punimet e ndërtimit ,transportit .
3	Ngjeshje e pjesshme e tokës nga lëvizja e automjeteve të transportit	Bëhet fjalë për ngjeshjen nga kamionet dhe fadromat që do të lëvizin në brendësi të sheshit të ndërtimit .Ky është një ndikim i pashmangshëm por që mund të shtypet vetëm duke zvogëluar sipërfaqen e kontaktit, pra të mos përdoren hapësira të pashkelura nese nuk nevojiten
4	Gjenerim i dherave dhe masë drusore ( shkurre ) që do të dalin nga procesi i sistemimit të sheshit të ndërtimit	Do të gjenerohet një sasi dheu tokeë aktive që është shtresa e sipërme ku do të vendoset objekti. Kjo masë është tokë aktive e cila do të përdoret për rehabilitimin e sheshit . Kjo masë dheu ka cilësi tepër të mira për zhvillimin e bimësisë kështu që kjo do të grumbullohet dhe sistemohet për të mos u gërryer

		nga erozioni i shiut. Ky grumbull dheu do të përoret si substrat i përkohëshëm i shkurreve që do të shkulen gjatë sistemimit të sheshit. Në këtë masë dheu bimësia e shkukur do të vazhdojë zhvillimin e saj normal nën kujdesin e vazhdueshëm të stafit duke u përdorur përsëri bashkë me masën e dheut në fazën e rehabilitimit dhe ringjalljes biologjike të sheshit
5	Erozioni minimal në kohë me rreshje në segmentin rrugor dhe sheshin ku do të depozitohen dherat e gërmimit	Nëse nuk do të merren masa për kontrollin e erozionit dhe llumrave mund të transferohen në pjesët e poshtme të objektit dhe me tej në trupat ujorë në zonë. Ky ndikim do të kontrollohet sipas masave të parashikuara në Planin e Menaxhimit. Dherat do të sistemohen dhe përdoren gjatë rehabilitimit duke shërbyer si fazë ndërmjetëse midis zhavoreve dhe masës së dheut ato shërbejnë për stabilizimin dhe krijimin e agregateve strukturore të tokës, porozitetit dhe drenazhimit. Do të bëhen kanale perimetrike në objekt dhe në sheshin e depozitimit të dherave, si mbulimi i masivit por bëhet fjalë vetëm për pasojat e reshjeve.
6	Ndotja e tokës si pasojë e avarive të makinerive.	Si pasojë e ndonjë avarije ose dëmtimi të kamioneve, eskavatorit apo fadromës mund të ketë rrjedhje të lubrifikanteve në toke, por kjo në sasi minimale
7	Ndikime në peisazhin, gjeologjinë, topografinë	Gjatë kesaj faze do të ndodhin disa ndryshime të pakthyeshme dhe të pashmangshme në peisazhin, topografinë dhe gjeologjinë e sipërfaqes
8	Ndikime në botën e gjallë ( faunen )	Edhe bota e gjallë do të ndikohet negativisht nga veprimtaria. Me gjithë kohëzgjatjen e ulët të parashikuar në veprimtari, lloje të ndryshme faunistike në objekt do të gjenden nën presion të vazhdueshëm sidomos nga zhurmat dhe shqetësimet. Këto ndikime janë të pashmangshme por masa për zbutjen e tyre mund të rezultojnë të sukseshme në fazat e ndryshme të zhvillimit të biodiversitetit sidomos në ciklin e riprodhimit. Keto masa do të mund të zbatohen me më tepër efikasitet gjatë vitit të dytë të shfytëzimit të objektit mbasi të jetë njohur mirë sjellja e biodiversitetit në objekt
9	Gjenerimi i mbetjeve të ambalazheve etj	Kartona, bidona dhe qese plastike që përdoren për të ambalazhuar paisje të ndryshme, për mbetjet e prodhuara nga aktiviteti I punonjësve

### Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut për fazën e operimit dhe shfrytëzimit të objektit

### **Rreziqet nga aksidentet potenciale dhe situatat e emergjencës gjatë fazës së operimit dhe shfytëzimit të objektit.**

Meqë natyra e veprimtarisë kërkon përdorimin e makinerive dhe nisur nga disa faktorë natyrorë që favorizojnë shfaqjen e situatave jo të zakonshme dhe të padëshiruara. Mbas analizës së skenarve të mundshëm rezulton se rreziqet me pasoja të konsiderueshme gjatë fazës së operimit mund të listohen:

- ✚ Rënie e ndonjë zjarri sidomos në stinën e verës
- ✚ Derdhje e sasive minimale të karburantit në mjedis
- ✚ Aksident i punonjësve gjatë proceseve teknologjike në objek sidomos gjatë kryerjes së ndërtimit
- ✚ Aksident gjatë levizjes së kamioneve në trafik për bazën materjale
- ✚ Dëmtim habitati dhe folesh të llojeve biologjike me status të vacant mbrojtje

### **Vlerësimi i ndikimeve në fazën e mbylljes së punimeve**

Mbas ndërtimit të objektit dhe mbylljes së veprimtarisë është planifikuar të realizohen punime rehabilitimi të konceptuara në dy faza sipas natyrës së punimeve dhe qëllimit të tyre.

### **Operacionet për rehabilitimin e e sipërfaqes të pa zënë nga ndërtimi do të realizohen në këto faza kryesore**

- Operacionet për largimin e makinerive
- Operacionet përgatitore për sistemimin dhe përshtatjen e sipërfaqes së sheshit për rehabilitim.
- Operacionet e mbjelljeve dhe kujdesit për rehabilitimin e sheshit të pa zënë

### **Ndikimet më të mundshme që lidhen me këtë fazë janë:**

- Emetime pluhurash dhe zhurme gjatë procesit të sistemimit të dherave nëpër sheshin bosh
- Emetim gazrash si pasojë e lëvizjes dhe transportit të paisjeve
- Derdhje aksidentale karburanti dhe hidrokarburesh nga mjetet e transportit

Këto janë ndikime të pashmangshme plotësisht, por që subjekti do të marrë masat e duhura që të minimizohen në maksimum, sidomos duke planifikuar eficensën dhe ulur kohëzgjatjen e realizimit të operacioneve.

### **e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;**

#### **Plani I reabilitimit**

Qëllimi kryesor i përgatitjes së Planit të Menaxhimit të veprimtarisë së ndërtimit të objekteve është shmangia, zbutja dhe kompesimi i mundshëm i ndikimeve negative, me qëllim që të reduktohen ndikimet deri në nivelet e pranuar. Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mirë ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga elementët e përshkruar më sipër, kompania nëpërmjet personelit të saj, ka përpiluar dhe zbaton një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedis. Filozofia e këtij plani mbështetet në këto parime të zbatueshme. Shmangia

është gjithmonë më e pranueshme por duhet ndarë pranimi i veprimtarisë bazuar në ligjet përkatëse si ndikimet e pashmangshme dhe ato ndikime që mund të zbuten.

### ***Masat që do të merren për zbutjen e ndikimit***

Ndikimet mjedisore të ndërtimit në sheshin e caktuar do të zbuten duke zbatuar me korrektësi teknikat e mëposhtme:

- Piketim të saktë të sipërfaqes së ndërtimit dhe operim vetëm brenda sipërfaqes
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagies së zonës së punës,
- Mbulimit të kamioneve gjatë transportit.
- Kontrollin e dherave të gjeneruara dhe sistemimin e tyre nëpërmjet kompaktimit dhe mbjelljes së pemëve që do të dalin nga pastrimi dhe hapja e sheshit me qëllim rivegetacionin e sheshit bosh
- Hapjen e kanaleve të nevojshme me qëllim drejtimin e ujërave të shiut dhe eliminimin e erozionit
- Kontroll teknik i mjeteve të punës për të parandaluar rrjedhjen e karburantit

Monitorimi është një proces i zbulimit të ndryshimeve nëse ato ndodhin, si dhe i percaktimit të drejtimit dhe matjes së shtrirjes së tyre. Objektivi themelor i këtij kapitulli është që të ofroje rekomandime të pershtatshme për mbrojtjen e zonës, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të mbrojtjes së cilësive dhe regjimit të ujërave që futen në turbina dhe dalin prej saj, të cilat do të derdhen pastaj në lume dhe do krijojnë problem. Procesi i monitorimit do të përqendrohet dhe fokusohet: Në aktivitetin e këtij hidrocentrali, në faktorët që gjenerojnë ndikime negative në mjedis, në efektet e këtyre ndikimeve, dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimet do të kryhen nga vetë investitori, dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkojë bashkëpunimi i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Verifikimet, monitorimet apo auditimet do të organizohen nga institucionet administrative si ARM-ja e Kuksi, AKM dhe Ministria e Mjedisit e turizmit

### **Plani i monitorimit**

Potencialet negative të përmendura më sipër mund të minimizohen duke marrë një sërë masash të cilat çojnë në përmirësimin dhe reduktimin e ndikimit në mjedis. Efektet potenciale ndotëse të mjedisit dhe masat mbrojtëse gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit

### **Pastrimi dhe përgatitja e sheshit**

Traseja nëpër të cilën do të ndërtohen kanalet e marrjes dhe do të shtrihet linja e tubacioneve ka shumë pak, ose aspak vegetacion të ulet. Asnjë dru nuk do të pritë që është jashtë trasesë së ndërtimit të kanaleve dhe shtrimit të tubacioneve të Hidrocentralit “ÇAM”. Të gjitha paisjet që do të kërkojnë të përdoren dhe sjellin zhurma me të mëdha duhet të kufizohen në orët e funksionimit, sipas situatës përreth. Në ditët që ato do të përdoren do të synohet të ketë një numër minimal të punonjësve në trasenë e kanaleve dhe të tubacioneve.

### ***Konflikti me përdorimin aktual të tokës si tokë bujqësore***

Nuk do të merret tokë me qira për trasenë e kanaleve dhe të tubacioneve, meqenëse punimet do të jenë kryesisht përgjatë shpatëve të maleve dhe në shtratin e lumit të Serriqes.

*Shqetësime të ndryshme për mundësi të shkaktohen komuniteteve tokale.*

Te gjitha lejet duhet te merren nga autoritetet e komunitetit dhe nese perkohesisht preken siperfaqe toke, ato pas perfundimit te punimeve duhet te kthehen ne gjendjen fillestare.

#### *Vendosia e veprave hidroteknike dhe e godines se hidrocentralit*

Nderhyrjet ne toke, gjate hapjes se kanaleve dhe per shtrimin e tubacioneve te dergimit te ujit ne hidrocentral, pritet te sjellin shqetesime te ndryshme. Gjeresia e trasese se kanalit te vepres qe do te hapet te jete minimale per te zvogluar demtimin e siperfaqes se tokes dhe te sasise se dherave te germuara.

#### *Magazinimi dhe trajtimi i materialeve te rrezikshme.*

Duhet treguar kujdes per te evituar ndotjen e tokes dhe ujit nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme te lubrifikanteve dhe solventeve qe do te perdoren gjate ndertimit te vepres. Nje plan emergjence duhet te pregatitet ne rast te rrjedhjeve te lubrifikanteve dhe solventeve.

#### *Hedhja e mbeturinave te ngurta dhe te lenget*

Problemet shqetesuese qe lidhen me ndotjen e mjedisit jane dhe mbetjet e ngurta qe do te gjenerohen gjate ndertimit te vepres hidroteknike. Keto mbetje do te duhet te hidhen ne vende te caktuara nga pushteti lokal.

#### *Problemet shqetesuese ne lidhje me kontaminimin e ujit*

Nuk do te lejohet hedhja e mbetjeve te ngurta apo te lengeta ne mjedis te hapur dhe ne vijat ujore.

### **Programi i monitorimit**

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar, qe te gjitha ndikimet e mundeshme qe do ti vijne mjedisit nga ndertimi dhe operimi i Hec- "ÇAM" jane marre parasysh. Programi i monitorimit per seicilen ndotje potenciale qe mund t'i shkaktohet mjedisit eshte dhene me poshte dhe duhet te mbikqyret nga Agjensia Rajonale e Mjedisit.

Aspektet kryesore qe do te jerie ne vemendje te monitorimit:

- Pastrimi dhe pregatitja e trasese se kanaleve dhe e tubacioneve te ujit; duhet te evitohet prerja drureve per pergatitjen e trasese. Si nje mase sigurie, miratimi i vijes se kalimit te trasese duhet te realizohet qe me pare nga pushteti lokal.
- Minimizimi i erozonit; duhet te jete nje detyre primare gjate pergatitjes se trasese se linjes se dergimit te ujit ne hidrocentral. Marrja me qera e shesheve ndihmese, monitorimi idokumentacionit te projektit te miratuar, eshte objekt i kontrollit te vazhdueshem i shoqerise zbatuese.
- Hedhja e materialeve te nxjerre nga pregatitja e trasese dhe hapja e rruges; kerkon mbajtien e shenimeve perkatese ne regjistrin e punimeve te kryera. Te behet dokumentimi i materialeve te ngurta te parrezikshme qe hidhen ne vendet e paracaktuara.
- Dergimi i materialeve dhe i paisjeve ne shesh; per kete aspekt eshte i nevojshem inspektimi i perhershem, i cili duhet te realizohet ne lidhje me kontrollin e emetimeve te pluhurit ne atmosfere gjate transportit te dheut.

### **Plani i monitorimit gjate operimit**

1. Te respektohet regjimi i rrjedhes se kushtezuar nga Agjensia e Basenit te Ujit Shkoder.
2. Operimi i paisjeve dhe makinerive; gjate procesit te ndertimit dhe funksionimit te Hec "ÇAM", duhet te monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet te kaloje nivelet e caktuara.
3. Te matet niveli i fushave elektromagnetike gjate operimit te hidrocentralit.

## **Plani per rehabilitimin e mjedisit.**

### Investimet e parashikuara per rehabilitimin e zones

Firma aktualisht pretendon te kryeje investime per vete aktivitetin qe ka. Investimet e saj do te jene ne kuadrin e mirembajtese se mjeteve dhe blerjen e projektit te shfrytezimit si dhe pergatitjen e dokumentacionit ligjor per marjen e "Lejes Shfrytezimit te HEC-it Çam".

### Parashikimi i realizimit te prodhimit vjetor ne objekt

Per shfrytezimin e rezerves ujore, do te perdoret sistemi i prodhimit te energjise elektrike me derivacion. Zona e percaktuar per shfrytezim dhe kerkuar nga subjekti ndodhet ne lumin SERRIQES . Siç` e kemi theksuar me siper shfrytezimi rezervave ujore behet i domosdoshem per faktin se erozioni natyror ushtron veprimtari gerryese ne shpatin perendimor duke eroduar siperfaqe te konsiderueshme tipike pyjesh. Duke pasur parasysht gjendjen aktuale e projektit teknik, shfrytezimin e kemi konceptuar ne dy faza:

#### *Faza e pare*

Pergatitjen e raportit te fizibilitetit, dhe marrjen e koncensionit per shfrytezimin e rezervave ujore per HEC me derivacion ( shif projektin dhe hartën).

#### *Faza e dyte*

Ndertimi i vepres hidroenergjitike, shfrytezimin e tij dhe prodhimin e energjise elektrike.

Bazuar ne kerkesen e vete subjektit, rezervave te shfrytezueshme, kapacitetit prodhues te HEC-ve, prodhimi vjetor ne objekt eshte parashikuar  $E_{totale} = 3,006,279 \text{ Kwh/vit}$ .

Mbetjet e prodhimit do te depozitohen e rihidhen në objekt per te frenuar gerryerjen e metejshme te shpatit.

#### **Organizimi**

Objekti do te jete nen administrimin e kompanise "EKO ENERGY" sh.p.k,. Ai do te kete ne perberje drejtues teknike e mekanike. Ne HEC-e do te punohet me turne, dhe puna eshte teresisht e mekanizuar.

Kapaciteti prodhues per HEC-in eshte  $E_{totale} = 3,006,279 \text{ Kwh/vit}$ .e parashikohet te punohet 100 dite/vit.

### ***Masat për rigjenerimin e sipërfaqes gjatë dhe pas shfrytëzimit***

1. Krijimi i sipërfaqes për mbjellje te reja e gjelberime.
2. Sistemimin e materialit të mbulesës dhe të sterileve që dalin gjate ndertimit.
3. Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidane shelgu, plepi, akacie.
4. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella.
5. Sistemimin e brigjeve anësore.
6. Mbjellje fidanesh të rinj.
  - 1- Mbjelljen e siperfaqeve te shfrytezuara të shkalleve me bime e peme.
  - 2- Sistemimi i sterileve.
  - 3- Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella.
  - 4- Sistemimin e skarpateve para e pas shfrytezimit.

### 1. Mbjelljen e sipërfaqeve të shfrytëzuara të shkalleve me bime e peme.

Duke qene se si pasoje e shfrytëzimit do te krijohen gropa, kanale projekti parashikon qe te mbillen peme ne keto sipërfaqe te lira. Per kete subjekti parashikon te shpenzoje nga fitimet e saj. Procesi per sistemimin e teracave dhe mbjedhjen e pemeve do te filloje mbas fillimit te shfrytëzimit ,dhe do te vazhdoje per 10 vjet deri ne fazen e shfrytëzimit duke mbjedhe cdo vit nga 500 renje peme. Keshtu gjithë sasia prej 11500 m<sup>3</sup> sterileve, do te sistemohen. Perkujdesja e firmes per zhvillimin e bimesise do te vazhdoje edhe mbas mbjedhjes.

### 2. Sistemimi i sterileve

Sistemimi i mbetjeve teknologjike sic theksohet me siper do te behet ne sheshin qe do te krijohet ne fazen e ndertimit dhe me pas kur te filloje sistemimi I skarpateve do te merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar kijimin e shtresave vegjetale e mbjedhjen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni I metejshe. Volumi I sterileve qe do te krijohen eshte 4600m<sup>3</sup>.

### 3. Mirembajtja e sipërfaqeve të mbjella

Ajo do te realizohet nga subjekti. Mund te ngrihen prita per te perforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni ne zonat reth karieres. Gjithashtu do te kujdeset per mbareshtimin e pemeve qe do te mbillen nga shoqeria. Per kullimin e ujrave qe do te grumbullohen ne sheshin e depozitimit te sterileve do te hapet nje kanal per drenimin e ujrave jashte sheshit te depozitimit .

### 4. Sistemimi i skarpateve para e pas shfrytëzimit

Subjekti ka per detyre e do te realizoje sistemimin e mirembajtjen e skarpateve te shkalleve ku aktualisht ai eshte i shkaktuar nga ndertimi. Ato do te mbahen nen vëzhgim gjate gjithë kohes se shfrytëzimit e me pas saj deri ne mbareshtimin e pyllit. Skarpatet do te mbushen me material steril, do te perforcohen me trugje e do te hidhen dhera te mbuleses mbi to. Mbasi te jete lidhur toka do te filloje mbjedhja e pemeve.

- 1) Mbjellja e sipërfaqeve të sheshit në pjesët periferike me bimë e pemë.
- 2) Sistemimi i sterileve(dhera).
- 3) Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella.
- 4) Mbjelljen e sipërfaqeve të sheshit bosh në periferi me bimë e pemë.

Duke qënë se si pasojë e gërmimit të themeleve dhe kanalit te ujesjellesit do të krijohen dhera të paster, projekti parashikon që të mbillen peme në këto sipërfaqe të lira. Për këtë subjekti parashikon të shpenzojë nga fitimet e saj. Procesi për sistemimin e sheshit dhe mbjedhjen e pemëve do të filloje mbas ndertimit te objekteve- kanal ujesjellesi Kështu gjithë sasia prej **250 m<sup>3</sup> sterileve**, do të sistemohen. Përkujdesja e firmës për zhvillimin e bimësisë do të vazhdoje edhe mbas mbjedhjes.

### 5) Sistemimi dherave

Sistemimi i dherave sic theksohet më sipër do të bëhet në sheshin që do të jetë bosh për të realizuar kijimin e shtresave vegjetale e mbjelljen e pemëve për mbrojtjen nga erozioni I mëtejshëm. Volumi i dherave që do të krijohen është 250m<sup>3</sup>.

### 6) Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella

Ajo do të realizohet nga subjekti. Gjithashtu do të kujdeset për mbarështrimin e pemeve që do të mbillen nga shoqëria. Për kullimin e ujrave që do të grumbullohen në sheshin e mbjellë. Për zbatimin e Planit të Menaxhimit subjekti do te trajnojë personelin e saj dhe do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me ekspertë të fushave , organet mjedisore dhe akademike. Efikasiteti i masave të Planit të Menaxhimit do të vlerësohen nga

rezultatet e tij konkrete në terren nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të suksesit që do të ketë. Plani i Menaxhimit do të përmirësohet dhe përshtatet në të ardhmen në varësi të kërkesave praktike.

#### **ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;**

**Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit.** Projekti për “Ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i” e ka të domosdoshme ndërtimin e sistemit të MKZ dhe në projekt ai është parashikuar, për vetë karakterin e funksionit dhe të rëndësisë që ka objekti HEC Çam . Konsiderohen si pika të mundshme të lindjes së zjarrit të gjithë objektet dhe ambjentet e tjera që përmbajnë materiale të djegëshme. Për këtë ajo do të marrë të gjitha masat parandaluese për rënien e zjarrit si gjatë punimeve të ndërtimit ashtu edhe gjatë funksionimit të objektit.

**Plani i Përballimit të Emergjencave.** Në veprimtarinë e vet subjekti, për aktivitetin, detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

#### **Shoqëria ndertuese ka për detyrë:**

- Të marrë masat e nevojshme për parandalimin e aksidenteve madhore mbi njerëzit dhe mjedisin.
- Të përgatisë dhe të mbajë një dokument që përcakton politikën e tij në lidhje me parandalimin e aksidenteve madhore (dokumenti i politikës së parandalimit të aksidenteve).
- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Politikat e përdorimit të tokës dhe politikat e tjera të lidhura me to të zhvilluara nga autoritetet përkatëse sipas legjislacioneve të veçanta marrin në konsideratë objektivat e parandalimit të aksidenteve madhore dhe kufizimit të pasojave të aksidenteve të tilla.
- Zhvillimeve të reja si lidhjet e transportit, vendet e frekuentuara nga publiku dhe zonat e banuara në afërsi të ndërmarrjeve ekzistuese, ku vendndodhja apo zhvillimet janë të tilla që rrisin riskun apo pasojat e aksidenteve madhore.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e Njësisë Vendore Tregan për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

#### **Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:**

- **Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë**

Sheshi ndërtimit të objekteve të HEC-it ka një sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e proceseve të operimit dhe funksionimit normal, të lëvizjes së lirë të punonjësve, magazinimin e lëndës së parë, disponon hapësira të mjaftueshme për parkim.

- **Rënia e zjarrit**

Në rastin e rënies së zjarreve, në territorin e Shoqërisë është e afishuar skema e lajmërimit. Mbi bazën e kësaj skeme personeli që ndodhet në objekt vepron duke bërë njoftimin e PMNZSH në numrat e zjarrfikëseve të afishuara në tabelat përkatëse. Brenda aktivitetit funksionon edhe lidhja telefonike dhe telefonat celulare që janë vendosur në dispozicion për lajmërimin e zjarrfikësve. Personeli present bazuar në skemën e afishuar vepron menjëherë me fikset e dorës dhe tenton të kufizojë përhapjen e mëtejshme të zjarrit. Pajisjet dhe



instalimet mbrohen me sistemin e shkumës antizjarr, rezervuari i ujit prej 20 m<sup>3</sup> e instaluar afër objekteve si dhe shuarës zjarri portable dhe të lëvizshëm, të vendosur në vende të sigurta.

- **Nga tërmetet**

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe bazamentet ku janë ngritur objektet, nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për instalimin, objektet, personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit.

- **Nga përmbytjet**

Sheshi i objektit ku janë ndërtuar objektet dhe janë instaluar paisjet dhe makineritë për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, të makinerive dhe paisjeve është i mbrojtur nga përmbytjet. Përreth objekteve janë ndërtuar rrjeti i kanalizimeve dhe gropa dekantimit gjatë gjithë linjës së shkarkimeve për grumbullimin e ujrave dhe gropat e dekantimit të sistemit të kanalizimeve të objektit, duke bërë të mundur precipitimin e lëndëve në pezull.

### **Menaxhimi i prodhimit**

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impianti të makinerive nga papastërtitë e lëndës së parë, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj. janë marrë këto masa:

- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend-parkimeve me sinjalistikën përkatëse. Është instaluar sistemi i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato kanë) si dhe lagia me ujë e sheshit të jashtëm gjatë periudhës Maj-Tetor, ujrati pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në gropën e dekantimit, këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme.
- Brenda objekteve kryhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat janë; lëndë të ambalazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit, ku këto mbetje depozitohen në vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku janë vendosur kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane të prodhuara, depozitohen në kosha brenda territorit të shoqërisë me volum 1 m<sup>3</sup> prej ku më pas merren nga mjetet e pastrimit të shoqërisë për t'i dërguar në venddepozitim të caktuar prej tyre.
- Rrjeti elektrik që furnizon linjën me energji elektrike është i tokëzuar dhe i gjithë sistemi është i lidhur me kutinë qëndrore të shpërndarjes, e cila është e siguruar me çelësin e sigurisë, për çfarëdo lloj avarie të mundshme për të gjithë objektet.
- Furnizimi me lëndë të parë uji, gjatë gjithë kohës së funksionimit të aktivitetit.

### **Masa për sigurimin teknik dhe mbrojtja në punë**

#### **Detyrimet e punëdhënësit**

Punëdhënësi vetë, ose nëpërmjet drejtuesit teknik që ka të punësuar, duhet t'ju bëjë të ditur punëmarrësve:

1. Proçesin e operacioneve në tërësi dhe të punës në frontin ku punon.
2. Shkaqet e aksidenteve dhe masat për menjanimin e tyre.

3. Rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të lëshuara nga dikasteret që lidhen me to.
4. Rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës dhe profesionin që kryen sipërmarrësi si individ për mbrojtjen e vetes dhe punonjësve të tjerë.
5. Rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik në vendet e punës, për tu mbrojtur nga makineritë, rrymës elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.
6. Ndhmën e parë shëndetësore.
7. Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjësve, dokumentohet sipas formalitetit të përcaktuar në rregulloren e sigurimit teknik.
8. Frontet e punës në zbatimin e objektit, po të punohet natën duhet të ndriçohen me projektore që furnizohen nga rrjeti elektrik në mënyrë të pavarur nga ndriçimi individual i mjeteve motorike. Kur mungon ndriçimi ndalohet puna.
9. Ndalohet qëndrimi dhe kalimi i punonjësve brenda rrezes së veprimit të mjeteve ngarkuese dhe transportuese të betonit, kur ato janë duke punuar.
10. Ndalohet riparimi i avarive, grasatimi dhe punime të tjera kur makineritë janë në lëvizje.
11. Para se të fillohet nga puna bëhet kontrolli i frontit të punës,

**Detyrimet e punëmarrësit:** Detyrimet kryesore janë:

1. Të njohë rregulloren e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të lëshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punës dhe ti zbatojë ato në punë.
2. Të dijë mirë shkaqet e mundëshme të aksidenteve për çdo proces pune.
3. Të sigurojë veten dhe punonjësit e tjerë gjatë procesit të punës në zbatim.
4. Kur konstaton shenja të një avarie të mundëshme që është burim aksidenti, në radhë të parë të marrë masa për eliminimin e saj, ndërkohe lajmëron gjithë punonjësit për rrezikun dhe ve në dijeni administratorin .
5. Të përdoren mjetet e mbrojtjes individuale në punë si: kapele, rrobat me çizme ose këpucë pune, doreza, maskat e mbrojtjes nga pluhuri, gazrat dhe tapa veshi për zhurmat, uniformë të veçanta etj.
6. Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.

Rregulloret e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të punimeve dhe subjektit privat, do të zbatohen në çdo proces punë të përcaktuar në plan- organizimin dhe plan menaxhimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve, i cili duhet të përmbajë :

- Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të punimeve;
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do të bëjë kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të punimeve për ndërtimin e një ujesjellesi dhe shatrivani për të cilat subjekti kërkon të marrë leje mjedisi;

- Rradha e kryerjes do të përcaktohet hollësisht në planin e masave tekniko-organizative dhe do të miratohet nga administratori i firmës;
- Në këtë plan tekniko-organizativ, masat e teknikës së sigurimit do të zënë vendin kryesor .
- Drejtuesi teknik i punimeve do të kryejë instruksione të rregullta mujore e tre mujore , ku do të trajtohen tema të veçanta për të gjitha profesionet dhe proceset që kryhen.
- Kujdes i veçantë do të tregohet në krijimin e kushteve të punës, pastrimin e sheshit të punës, mirëmbajtjen e makinerive dhe paisjeve, pastrimit të magazinave dhe, rrugëve të brendshme të transportit, vendosjen në punë të paisjeve dhe menaxhimin e operimit të tij, etj.

### **Rreziku në shëndet dhe masat për zbutjen e tij, masat e sigurimit teknik**

Rreziku në mjedis për procesin e ndërtimit është present si në ndërtim dhe funksionim

- Administratori dhe drejtuesi teknik i shoqërisë bëjnë vazhdimisht instruksionin teknik të punonjësve.
- Një metodë efikase mbetet trajnimi teorik jo me shumë se një muaj dhe trajnimi në punë.
- Si trajnim në punë këshillohet të punohet në mbikqyrje për jo më pak se një javë në të gjitha proceset e ndërtimit dhe prodhimit.
- Për evidentimin e efektit të zhurmave, gazeve e pluhurave, punonjësit, gjatë operacioneve që gjenerojnë zhurma, pluhura, gazra siç janë përcaktuar në pjesën ku trajtohen ato është i nevojshëm përdorimi i aparaturave përkatëse për kapjen e zhurmës
- Për reagimin e menjëhershëm ndaj aksidenteve të mundshëm humane, objekti disponon edhe një ambient ku mbahet kutia e ndihmës së shpejtë dhe vendosen mjetet personale të punonjësve. Çelsat e këtij ambienti ruhen me kujdes dhe njëkohësisht janë në dispozicion të kujdo që nevojitet në çdo orë të ditës.
- Për uljen e rrezikut të aksidentimit të punonjësve dhe banorëve nga mjetet e transportit brenda objektit dhe në rrugën kryesore, shpejtësia e mjeteve të mos i kalojë 20km ëorë brenda objektit.

### **Sigurimi teknik në proceset e punës**

#### **Zbatimi i normave të rregullores së teknikës së sigurimit**

Gjatë ushtrimit të aktivitetit subjekti mban parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe më të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

- Në të gjitha operacionet të punësohen specialistë me eksperiencë pune në kryerjen e proceseve të ndryshme të përdorimit të instalimeve.
- Rregullore e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të drejtimit të operacioneve, zbatohet në çdo proces pune të përcaktuar në plan-organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës.
- Plan menaxhimi i punimeve hartohet para fillimit të çdo operacioni të funksionimit të aktivitetit
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar bën kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të punimeve të çdo lloji për të cilat subjekti është licënsuar.
- Rradha e kryerjes së veprimeve përcaktohet hollësisht në planin e masave tekniko organizative dhe është i miratuar nga përfaqësuesi i shoqërisë.
- Në këtë plan tekniko-organizativ masat e teknikës së sigurimit zenë vendin kryesor.
- Drejtuesi teknik i punimeve kryen instruksione të rregullta mujore e tre mujore, ku trajtohen tema të veçanta për të gjitha profesionet dhe operacionet që zhvillohen brenda instalimit për prodhimin e produkteve të betonit dhe betonarmesë.
- Kujdes i veçantë tregohet në krijimin e kushteve të punës, pastrimit të objektit dhe instalimit dhe monitorimit të parametrave mjedisore, etj.

- Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit të zonës

### **Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë dhe të punës:**

Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike. Impiantet e nevojshme janë projektuar në përputhje me Ligjin e ri, nr.9379, datë 28-04-2005 “Për Eficencën Energjisë”, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive me eficientë.

- Punëtorët duhet të informohen për rreziqet në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e tyre dhe masat për t'i parandaluar ato. Përveç kësaj, ata duhet të marrin trajnim dhe të marrin materiale të sigurisë në përputhje me përvojën e tyre. Ata duhet të kenë një certifikatë trajnimi. Për disa fusha të punës është i nevojshëm trajnimi specifik. Nga ana e punëdhënësit duhet të sigurohet një ambient pune i sigurt dhe i shëndetshëm në përputhje me Ligjin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Duhet hartuar një vlerësim i rreziqeve për çdo punë ku identifikohen rreziqet dhe të përcaktohet dhe zbatohen masat për eliminimin e tyre.
- Para fillimit të punës duhet:
  - Ta udhëzoj punonjësën në një ekzaminim mjekësor, para fillimit të punës.
  - Kostoja e ekzaminimit mjekësor përballohet nga punëdhënësi.
  - Të informoj punonjësën e ri mbi vlerësimin e rrezikut e vendit të punës së tij.
  - Për punonjësën e ri të organizoj trajnime për sigurinë dhe shëndetin në punë. Trajnimi kryhet nga një inxhinier i sigurisë .
  - Do të respektohet V.K.M.Nr. 10 237, datë 18.2.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë"
- Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon me Tapi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin e zonave përreth.
- Do të instalohet sistemi i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e sheshit gjatë periudhës Maj-Tetor.
- Linjat e prodhimit të instaluar në objekt, do të kolaudohen në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe certifikuar për të tilla procese.
- Veglat e punës dhe autobotet që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficientësisë që kanë në kryerjen e operacioneve të prodhimit.
- Mbetjet nga proceset e punës për prodhimin, do të grumbullohen në vendin e caktuar nga subjekti dhe mbas plotësimit të një sasive të konsiderueshme do të ripërdoren sërish me qëllim riciklimin dhe ripërdorimin e tyre.
- Ambienti i zyrave dhe pajisjetëmjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhen periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Rrjeti elektrik është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike.
- Transporti i lëndës së parë do të bëhet nga mjete të pastra nga balta (gomat e automjeteve do të pastrohen para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjetet transportuese të mbulohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e produktit në rrugë dhe krijimin e pluhurave.
- Zona ku do të realizohen operacioni i prodhimit të betonit është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Në zonën ku janë të instaluar linja e impiantit janë vendosur 4 (katër) hidrante, për fikjen e zjarrit. Mbahet një rezervë e

konsiderueshme uji prej 10 m<sup>3</sup> në depozita. Rrjeti për shuarjen e zjarreve është i lidhur me rrjetin e ujit përkatës për nevojat e këtij aktiviteti. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë, do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit

- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Është ndërtuar sistemi i drenazhimit dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Për të shmangur ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga Ujërave të Ndotura Urbane të kësaj zone është realizuar lidhja me gropat e dekantimit e cila bën dekantimin e ujrave të ndotura urbane. Ujrat grumbullohen nëpërmjet sistemit të drenazhimit i cili e përshkon të gjithë sipërfaqen e objektit ku janë të instaluar impianti dhe me rrjedhje të lirë ujrat drejtohen për nga puseta e dekantimit, më pas ujrat e pastra shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës.
- Ndërsa në lidhje me burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë objektet dhe instalimet, por jo aq sa të dëmtojë pajisjet hidraulike ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në impiantet e prodhimit të produkteve.

#### **Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga ndertimi .**

- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm që gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet lagia e sipërfaqeve të sheshit para objekteve gjatë stinës së verës, pastrimi i vendit së depozitimit të lëndës së parë, si dhe të rrugëve komunikuese.
- .


#### **Programi i monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit**

Programi i monitorimit të punimeve për zbatimin e projektit, fokusohet në mbledhjen e të dhënave mjedisore të veprimtarisë së shoqërisë dhe përdorimin e tyre për përmirësimin e mënyrës së operimit, korigjimit dhe marrjen e masave shtesë të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit. Dokumentacioni mjedisor tabelar do të mbahet në objekt gjatë gjithë afatit të punimeve. Për sa më sipër janë menduar që të përzgjidhet për t'u monitoruar nga vetë firma ato elementë që realisht mund të identifikohen, maten, dhe komunikohen në organet e administrimit të mjedisit, ARM dhe firma zbatuese e punimeve.

Në rastin ndertimit të objekteve social do të monitorohen; zhurmat, ndotja e ajrit, ndotja e ujrave.



# PLANVEDOSJE NE HARTE TOPOGRAFIKE E HEC QAM



HEC QAM (KRGJSH)	X	Y
Godina e centralit	518620	4662134
Baseni i presioni	518569	4662185
Vepra e marrjes	517309	4661311
Basen i dekantimit	517379	4661308

**Legend**

- Veprat
- Gjurma e Hec